



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

RAPORTI VJETOR 2020

SHËNIM

Nga muaji Mars i vitit 2020, me propozim të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Republikën e Kosovës është shpallur gjendje pandemie. Si pasojë, shumë nga aktivitetet e planifikuara ishin ndërprerë, puna ishte zhvilluar nga distanca e me staf esencial, shumë nga shërbimet ishin ndërprerë e shumë nga projektet e planifikuara kapitale ishin pezluar.

PËRMBAJTJA

FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV.....	8
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	11
1.1 MANDATI DHE PËRGJEGJËSITË	12
1.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE	13
1.3 BUXHETI.....	16
1.4 PROKURIMI PUBLIK	19
2. AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE TEKNIKE DHE PROFESIONALE	21
2.1 PROJEKT LIGJI PËR KADASTËR TË PRONAVE TË PALUAJSHME	21
2.2. PROJEKT LIGJI PËR KRIJIMIN E INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE TË INFORMACIONIT HAPËSINOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	23
2.3. PROJEKT RREGULLORJA PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË KADASTRALE TË KOSOVËS	25
2.4. UDHËZIMI ADMINISTRATIVE NR. 09/2020 PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTAVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME.....	26
2.5 KORNIZA E PUNËS NR. AKK 2020/01 PËR MATJE, KRIJIM DHE REGJISTRIM TË NJËSIVE KADASTRALE (PARCELË, NDËRTESE DHE PJESË TË NDËRTESES)	28
2.6 DORACAKU PËR RINDËRTIMIN E INFORMACIONEVE KADASTRALE.....	30
2.7 DORACAKU PËR KADASTRIN E NDËRTESAVE	32
2.8 UDHËZUES PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME NË KADASTËR	33
2.9 DORACAKU PËR SISTEMIN E ADRESAVE	35
2.10 UDHËZUESI DHE QARKORJA NR.1 PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE	36
3. SHËRBIMET DHE PËRKRAHJA E OFRUAR NGA AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS	37
3.1 SHËRBIMET KADASTRALE OFRUAR INSTITUCIONEVE PUBLIKE	37
3.2 ELABORATET E SHPRONËSIMIT DHE KËRKESAT E PALËVE.....	38
3.3 SHËRBIMET JURIDIKE.....	38
3.4 SHËRBIMET PËR QYTETARËT NGA ZYRAT KADASTRALE KOMUNALE DHE AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS	39
3.5 OFRIMI I QASJEVE NË TË DHËNA KADASTRALE PËR INSTITUCIONE PUBLIKE	41
3.6 SHËRBIMET NGA POZICIONIMI SATELITOR I KOSOVËS – KOPOS	42
3.7 SHËRBIME NGA GJEPORTALI SHTETËROR.....	44

4. ZHVILLIMET NË SISTEMIN E INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË.....	45
4.1 UNIFIKIMI I EMRAVE TË PRONARËVE TË REGJISTRUAR ME EMRA TË NDRYSHËM NË SIKTK.48	
4.2 REGJISTRIMI, MODIFIKIMI DHE FSHIRJA E HIPOTEKAVE NË FORMË DIGJITALE	50
5.MONITORIMI I PUNËVE DHE AKTIVITETEVE TË ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE GJEODETE DHE GJEODETËVE TË LICENCUAR.....	53
6. LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE	56
7. SISTEMI I UNIFIKUAR I ADRESAVE	58
8. AVANCIMI I BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONE PUBLIKE	62
8.1 MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE PUBLIKE.....	63
9. KOORDINIMI I PROJEKTEVE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	65
9.1 PROJEKTI PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME DHE INFRASTRUKTURËS GJEODHAPËSINORE (REGIP)	66
9.2 PROJEKTI PËRKRAHËS I QEVERISË NORVEGJEZE.....	69
9.3 PROJEKTI SPATIAL II I PËRKRAHUR NGA QEVERIA HOLANDEZE	71
9.4 PROJEKTI PËRKRAHËS I QEVERISË JAPONEZE	73
9.5 INICIATIVAT E AKK-SË PËR ZGJERIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR DHE REGIONAL.....	75
10. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT.....	81
10.1 ADMINISTRIMI I INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË DHE SISTEMEVE TË INFORMACIONIT (TI/SI)	81
10.2 PËRKRAHJA E PËRDORUESVE TË SISTEMEVE DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (SI/TI)	84
10. 3 IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË SË TI-SË	85
11.MARRËDHËNIE ME PUBLIK DHE GJITHËPËRFSHIRJA	86
12.MANIFESTIM PËR 20 VJETORIN E THEMELIT TË AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS.....	87
13.VIZIONI PËR VITIN 2021	88
14. KALENDARI KRONOLOGJIK.....	94

SHKURTESAT

AKK – AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

ARIS – SISTEMI I INFORMACIONEVE PËR REGJISTRIN E ADRESAVE

IKIH- INFRASTRUKTURA KOMBËTARE E INFORMACIONEVE HAPËSINORE

INSPIRE – DREKTIVA E BASHKIMIT EVROPIAN 2007/2 MBI INFRASTRUKTURËN E INFORMACIONEVE HAPËSINORE

KOPOS – SISTEMI I POZICIONIMIT SATELITORË NË KOSOVË

MEA – MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT

MMPH – MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

REGIP – PROJEKTI PËR REGJISTRIMIN E PRONËS DHE INFRASTRUKTURË GJEOPHAPËSINORE

SIKTK – SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË

SIKTK-HK – SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË-HARTA KADASTRALE

SIKTK-T – SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË-TEKSTUALE

SOA – ARKITEKTURË E ORIENTUAR NË SHËRBIME, ANG. SERVICES ORIENTED ARCHITECTURE

ZKK – ZYRA KADASTRALE KOMUNALE

FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV



Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) gjatë vitit 2020 shënoi 20 vjetorin e themelimit, ndërsa ajo që ishte paraparë të ishte vit kushtuar aktiviteteve jubilarë krahas atyre kapitale, rezultoi të ishte viti më sfidues që nga themelimi i saj, si pasojë e pandemisë COVID19. Sidoqoftë, ajo që duhet potencuar është se për asnjë moment nuk ndaluan së ofruari shërbime për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

Për më shumë, në disa fusha rezultuam edhe më të suksesshme krahasuar me vitet e kaluara, e kjo u dëshmuar përmes fuqizimit të AKK-së në politikbërje, përmes avancimit të kornizës ligjore, përmes publikimit të materialeve profesionale e teknike dhe përmes gjithëpërfshirjes shoqërore, profesionale e politike, vendore dhe ndërkombëtare. Organizuam takime dhe vizita me Kryeministrin e zv. Kryeministrin e Parë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Ministrin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambienti me zv. Ministren e po të njëjtës Ministri.

Patëm takime me krerët e USAID, me kreun e Zyrës së BE-së dhe me kreun e OSBE-së në Kosovë, me krerët e JICA, SIDA, UN HABITAT, GIZ. Bashkëpunuam me Bankën Botërore, Qeverinë Norvegjeze, Qeverinë Holandeze, bashkëpunuam edhe me “Eurogeographics”, organizatë kjo që grumbullon gjitha homologet e AKK-së nga shtetet e BE-së e më gjerë.

Në të gjitha këto takime, u vlerësua puna jonë dhe u premtua vazhdim i bashkëpunimit. Bashkëpunimi me Bankën Botërore rezultoi me ratifikim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i Projektit për Regjistrimin e Pronës në Kadastër dhe për Infrastrukturë të Informacioneve Hapësinore.

Reformat e filluara gjatë vitit 2019, vazhduan edhe gjatë vitit 2020 me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2020 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme.

Po ashtu gjatë këtij viti publikuam edhe dokumentacion tjetër profesional e teknik përfshi Doracakun për Kadastrin e Ndërtesave, Doracakun për Rindërtimin e Informacioneve Kadastrale, Doracakun për Sistemin e Adresave, Udhëzuesin për Procedurat e Regjistrimit të Pronës, Kornizën e Punës për Matjen, Krijimin dhe Regjistrimin e Njësive Kadastrale.

Gjithashtu, finalizuar Planin Strategjik 2021-2025 dhe Planin e Biznesit dhe Veprimit 2021-2023+, dokumente gjithëpërfshirëse që përcaktojnë rrugën që AKK duhet ndjekur me qëllim të avancimit të kadastrës konform zhvillimeve në shtetet e zhvilluara.

Monitoruam punën e Zyrave Kadastrale Komunale, Kompanive të Licencuara Gjeodete dhe Gjeodetëve të Licencuar. Prodhuan një raport me të gjeturat dhe të njëjtat ua prezantuam Kryetarëve të Komunave.

Takuam Kryetarët e Komunave Lipjan, Fushë Kosovë, Prizren, Klinë, Malishevë, Rahovec me të cilët diskutuam për fushat e interesit të përbashkët me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit. Një kapitull i veçantë këtë vit iu kushtua edhe zhvillimeve teknologjike, përgatitjes së ueb shërbimeve dhe avancimeve në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë, krejt me qëllim të ofrimit të qasjes në të dhëna për institucione tjera të interesit.

U përfshinë Oda e Noterëve, Oda e Përmbauesve, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, Agjencia Kosovare e Inteligjencës, Forca e Sigurisë së Kosovës, Sekretariati i Këshillit të Sigurisë, Njësia për Inteligjencë Financiare, Policia e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Këshilli Prokurorial i Kosovës e Këshilli Gjyqësorë i Kosovës. Pos sektorit publik, përfshimë edhe atë privat. Ofruam qasje në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme edhe për bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare. Mundësuar trajnim për qasje e operim në SIKTK për të gjitha këto institucionet. E arritura kryesore nga ofrimi i qasjes së limituar në regjistra për bankat komerciale, mes tjerash ishte edhe ofrimi i mundësisë së regjistrimit dhe fshirjes së hipotekave “online”. Nga kjo përfituan edhe bizneset e edhe qytetarët.

Me shumicën e bashkëpunëtorëve nënshkruam Memorandume të cilat tani më janë duke u implementuar. Gjatë vitit ofruam ekspertizën tonë në draftimin e Ligjit për Trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe ofruam trajnime për implementim të ligjit si dhe ofruam kontribut profesional në draftimin e Udhëzuesit për Legalizim dhe Qarkores Nr. 1 për trajtimin e objekteve pa leje në nivel komunal. Edhe në Sistemin e Adresave shënuam progres në bashkëpunimin me të tjerët. Përfshimë Postën e Kosovës, KEDS-in dhe Forumin për Shkëmbimin e të Dhënave përmes nënshkrimit të Memorandumeve për shfrytëzim të adresave zyrtare. Gjatë rrugëtimit njëvjeçar identifikuar sfida të reja të cilat do të tejkaloheshin me aprovimin e dy ligjeve të reja, atë për Kadastër dhe për Infrastrukturë Kombëtare për Informacione Hapësinore.

Ndërsa, edhe vizionin për vitin 2021 e kemi të qartë. Do të fokusohemi në avancimin e e-Kadastrës, kompletimin e sistemit të adresave dhe krijimin e aplikacionit vendor për navigim për nevoja të qytetarëve, institucioneve e bizneseve. Po ashtu, do të krijojmë edhe Gjeoportalin e ri shtetëror, do të korrektojmë të dhënat, do të kompletojmë arkivin digjital dhe do të kompletojmë të gjitha llojet e rrjeteve gjeodezike me rrjetin e nivelimit. Sa i përket aspektit shoqëror, gjatë vitit mbajtëm të informuar qytetarët dhe bashkëpunëtorët përmes gazetës tonë periodike “Kadastra”, përmes videove informative, përmes uebfaqes e përmes rrjeteve sociale.

Po ashtu, me rastin e 20 vjetorit të themelimit, vlerësuam me mirënjohje kontributin e institucioneve vendore e ndërkombëtare dhe ekspertëve vendor e ndërkombëtar në themelimin dhe avancimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Nga të njëjtit kërkuam edhe përkrahje e bashkëpunim për të ardhmen, duke potencuar se nga bashkëpunimi i ndërsjellë përfitojnë që të gjithë.

Për fund, raporti në vijim paraqet një përmbledhje të aktiviteteve tona që kemi realizuar gjatë vitit 2020, dhe një vizion të qartë për vitet para.

Avni Ahmeti

Drejtor Ekzekutiv

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 MANDATI DHE PËRGJEGJËSITË

Agjencia Kadastrale e Kosovës është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave.

Si institucion i nivelit qendror, AKK ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve dhe kornizave të punës lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale, është përgjegjëse për trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve në Zyrat Kadastrale Komunale për operim në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovës (SIKTK) dhe për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete për ofrimin e shërbimeve kadastrale.

Duke u bazuar në Ligjin për Kadastër AKK ka deleguar tek ZKK-të detyrat për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave në SIKTK. ZKK-të ofrojnë shërbime për persona fizik dhe juridik si dhe për institucionet publike në 35 nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, ndërsa në tre Komuna, respektivisht në Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan edhe krahas përpjekjeve të AKK-së administrimi i kadastrës nuk po bëhet konform legjislacionit të Republikës së Kosovës.

Si rezultat i kësaj dhe me qëllimin e ofrimit të shërbimeve kadastrale për qytetarët e këtyre tri komunave, AKK duke u bazuar në Ligjin për kadastër ka vendosur që të pranojë kërkesat e qytetarëve të tri komunave veriore, dhe për të njëjtat të lëshohen dokumente kadastrale dhe pronësore, si dhe të bëhet mirëmbajtja e Regjistrit të të Drejtave mbi Pronat të Paluajtshme.

Të drejtat, përgjegjësitë dhe në përgjithësi mandati i AKK-së është i rregulluar me Ligjin për Kadastër dhe me akte të tjera nënligjore, të gjitha të qasshme përmes linkut <http://www.kca-ks.org/legjislacioni>.

1.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE

Agjencia Kadastrale e Kosovës vepron në bazë të Rregullores me Nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, të aprovuar me datë 08.12.2014.

Bazuar në këtë rregullore AKK në strukturën e saj organizative ka gjithsej 5 Drejtori dhe 14 sektorë. Numri i të punësuarve të aprovuar nga Buxheti për vitin 2020 është 52 punëtor. Aktualisht numri i të punësuarve në AKK është 51, prej tyre: 33 Meshkuj & 18 Femra.

Mosha mesatare është 42 vjet.

Në Agjencinë Kadastrale janë të punësuar edhe shtatë (7) zyrtarë si staf mbështetës të cilët janë të financuar nga donatorët, prej tyre janë 5 meshkuj dhe 2 femra.



Një pjesë e personelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës

1.3 BUXHETI

Agjencia Kadastrale e Kosovës financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga grante e huamarrje nga donatorët. Nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, të aprovuar me 15.03.2020 përmes Ligjit të buxhetit Nr.07/L-001, Agjencisë Kadastrale të Kosovës i janë ndarë 1,708,089.00€, të kategorizuara në katër kategori, respektivisht paga dhe mëditje në vlerë 368,739.00€, mallra dhe shërbime në vlerë 715,000.00€, shërbime komunale në vlerë 9,350.00€ dhe pasuri jo financiare 615,000.00€, të paraqitura në tabelën vijim:

Destinimi	Buxheti i planifikuar	Buxheti i aprovuar	Buxheti i rishikuar
Totali:	3,818,459.30	1,708,089.00	1,411,725.00
Pagat	392,959.30	380,190.00	380,190.00
Mallra dhe Shërbime	172,000.00	715,000.00	745,000.00
Shërbime Komunale	6,500.00	9,350.00	5,486.00
Pasuri jo Financiare	3,247,000.00	615,000.00	292,500.00

Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave me datë 15.11.2018, kishte negociuar marrëveshjen Financiare me Bankën Botërore për Projektin për Regjistrimin e Pronës në Kadastër dhe për Infrastrukturë Gjeohapësinorë (REGIP). Ky projekt do të implementohet nga AKK ndërsa vlera e planifikuar e mjeteve për vitin 2020 për financim të fillimit të aktiviteteve përgatitore deri në aprovimin të projektit nga Parlamenti i Republikës së Kosovës ishte 250,000.00€, nga të cilat u aprovuan 200.000€.

Meqenëse shumica e aktiviteteve që do të zhvillohen nga ky projekt i përkasin kategorisë së shërbimeve konsulente dhe shërbimeve tjera operationale, AKK ka kërkuar transferimin e mjeteve nga kategoria e kapitaleve në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 30,000.00€, ndërsa kjo kërkesë është aprovuar nga Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, e paraqitur si në tabelën në vijim:

Destinimi	Buxheti i planifikuar	Buxheti i aprovuar	Buxheti i rishikuar
Totali:	250,000.00	200,000.00	115,000.00
Mallra dhe Shërbime	<i>(Për mallra dhe shërbime nuk ka pasur mjete të aprovuara)</i>		30,000.00
Pasuri jo Financiare	250,000.00	200,000.00	85,000.00

Në kuadër të planifikimit të buxhetit për vitin 2020, AKK ka planifikuar buxhet edhe për Projektin e Bankës Botërore-REGIP, ku një pjesë e mjeteve janë planifikuar për kategorinë mallra dhe shërbime nga huamarrja dhe pjesë e projekteve kapitale te klauzola e investimeve. Në tabelën në vijim është paraqitur pasqyra e buxhetit nga huamarrja, e ndarë sipas kategorive:

Destinimi	Buxheti i planifikuar	Buxheti i aprovuar	Buxheti i rishikuar
Totali:	2,482,020.00	3,262,000.00	3,262,000.00
Mallra dhe Shërbime (04)	729,020.00	100,000.00	100,000.00
Pasuri jo Financiare (06)	1,753,000.00	3,162,000.00	3,162,000.00

Sa i përket realizimit të buxhetit, në vitin 2020 AKK ka shpenzuar 753,191.56€, apo rreth 71% të ndarjes finale të buxhetit, të paraqitura si në tabelën në vijim:

Destinimi	Buxheti	Alokimi	Shpenzimi	Buxhet / Shpenzim
Totali:	1,067,454.22	1,067,454.22	753,191.56	71%
Pagat	362,269.89	362,269.89	362,269.89	100%
Mallra dhe Shërbime	618,460.00	618,460.00	305,018.02	50%
Shërbime Komunale	3,684.33	3,684.33	2,863.65	78%
Pasuri jo Financiare	83,040.00	83,040.00	83,040.00	100%

Koment: Raporti është hartuar bazuar në raportin zyrtar nga Sistemi i Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësi (SIMFK).

Në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve është i përfshirë edhe projekti “Skanimi i dokumenteve arkivore”, ku një pjesë e financimit të këtij projekti është paraparë nga huamarrja.

Kur AKK i ka deklaruar kursimet, ka deklaruar edhe mjetet e këtij projekti, në vlerë prej 238,000.00€, po që MMPH i ka larguar nga lista e kursimeve mjetet e parapara për projektin në fjalë, me arsyetim se projekti është huamarrje e nuk mund të largohet.

Si rezultat i kësaj realizimi i buxhetit është 71%. Në tabelën në vijim është pasqyruar buxheti dhe shpenzimet sipas kategorive për pjesën e Huamarrjes:

Destinimi	Buxheti	Alokimi	Shpenzimi	Buxhet /Shpenzim
Totali:	3,322,000.00	1,038,026.35	124,283.14	4
Mallra dhe Shërbime 04	160,000.00	160,000.00	124,283.14	78
Pasuri jo Financiare 06	3,162,000.00	50,000.00		0

Gjatë vitit 2020 AKK ka realizuar në total 348 pagesa, respektivisht për mallra dhe shërbime 294 pagesa, për komunal 15 pagesa, 2 pagesa për kapitale, dhe 37 pagesa nga projekti REGIP i Bankës Botërore.

Për vitin 2020 AKK kishte të planifikuara edhe të hyra në vlerë prej 120.000€ ndërsa përmes Sektorit të produkteve ka realizuar 105,681.50€. T hyrat janë gjeneruar nga dy kategori, ajo e licencave për kompani gjeodete dhe për gjeodetë, dhe ajo e produkteve tjera.

Të hyrat e inkasuara hyjnë në buxhetin e Republikës së Kosovës dhe nuk shfrytëzohen nga AKK.

Të hyrat e gjeneruara nga AKK janë paraqitur në tabelën në vijim:

Nr.	Emërtimi i produktit-shërbimit	Sasia
	Kodi, Titulli	
1.	10, 20.Regjistrim i të drejtës së pronësisë sipas vlerës transaksionit: 10.001-50.000 euro, neni 5, p.1.1.2 UA.nr. 09/2020	1
2.	AKK, 2.26-2019-08 Harta topografike e re GjeoTIFF - Raster - për fletë të hartës	155
3.	Kadastër, 08/2014 Neni 4. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë - posedimit	1
4.	RDPP, Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqsore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë-posedimit	1
5.	AKK, Taksa për kompani gjeodete të licencuara	7
6.	AKK, Taksa për gjeodet të licencuar	31
7.	AKK, Taksa për teknik gjeodet i licencuar	24
8.	Regjistrim i pronësisë në bazë të dokumentit të dhuratës - vlera 50000-100000-30% e vlerës së tarifës sipas UA 08/2014	1
9.	AKK, UA Nr.13-2019-Licencë - Kompani gjeodete	2
10.	AKK, UA Nr.13-2019-Licencë - gjeodet	6
11.	AKK, UA Nr.13-2019-Licencë - teknik gjeodet	1
12.	SIKTK, (2019) Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura)	11
13.	AKK, 2019-08Tarifa 1 mujore për një shfrytëzues - Rinex dhe Postprocesim	1
14.	AKK, 2019-08Tarifa 1 mujore për një shfrytëzues - RTK	20
15.	AKK, 2019-08Tarifa 6 mujore për një shfrytëzues - RTK	8
16.	AKK, 2019-08Tarifa 1 vjetore për një shfrytëzues - Rinex dhe Postprocesim	2
17.	AKK, 2019-08Tarifa 1 vjetore për një shfrytëzues - RTK	157
18.	AKK, 2019-0 Regjistrimi fillestar i një shfrytëzuesi	14
19.	AKK, 2019-08Informata për njësi kadastrale	150
20.	AKK, 2019-08Nxjerrja e koordinatave për një pikë detale	1144

21.	AKK, 2019-08 Transformimi i koordinatave	741
22.	AKK, 2019-08 Modeli digjital i terrenit MDT 2018 për km2	21
23.	AKK, 2019-08 Harta topografike e re GjeoTIFF - Raster - për fletë të hartës	6
24.	AKK, 2019-08 Parcela - vektor(shapefile, DWG) nga 1.01ha deri në 2 ha	1
25.	AKK, 2019-08 Parcela - vektor (shapefile, DWG) deri në 1 ha	74
26.	AKK, 2019-08 Kufiri i Republikës së Kosovës - vektor	1
27.	AKK, 2019-08 Harta kadastrale digjitale - e vjetër	3
28.	AKK, 2019-08 Ortofoto digjitale - rurale 2018	7
29.	AKK, 2019-08 Ortofoto digjitale - urbane 2018	60
30.	AKK, 2019-08 Ortofoto me plan kadastral përsipër-kopja 1 (1:500, 1:1000, 1:2500, 1:5000)	2
31.	AKK, 2019-08 Ortofoto - letër e thjeshtë-kopja 1 (1:500, 1:1000, 1:2500, 1:5000)	3
32.	SIKTK, 1.4.(2019)Kopja e planit	316
33.	SIKTK, 1.1.(2019)Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona	8
34.	DK, Regjistrimi i pronësisë sipas vendimeve administrative	0
35.	Kadastër-RDPP, Regjistrim i pronësisë në vlerë të kontratës 50 000-100 000 Euro	1
36.	DK, Regjistrimi i pronësisë sipas vendimeve administrative	1
37.	DK, Regjistrimi në regjistër i të dhënave nga tereni	2
38.	DK, Regjistrim i pronësisë-vlera e transaksionit deri 10000 Euro	8
39.	kadastër, Regjistrim prone-Dhurate(përfituesi anëtar i familjes-vlera e përcaktuar e pronës , tarifa 30% 3 nenit 2 te UA 08/2014)	2
40.	Regjistrim prone - kontratë mbi dhurimin	1
41.	DK, Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit - qirambajtje deri në 99 vite	1
42.	DK, Ndarje e njësive kadastrale	7
43.	DK, Korrigjimi i të dhënave në regjistër	4
44.	DK, Regjistrim prone - trashëgimi	29

45.	DK, Regjistrim lënde (kadastër)	9
46.	DK, Kopja e planit	2
47.	DK, Certifikata e pronësisë	349
48.	5.7, Tarifa një (1) mujore për një shfrytëzues Rinex dhe Postprocesim	2
49.	5.6, Tarifa një (1) mujore për një shfrytëzues RTK	13
50.	5.4, Tarifa gjashtë (6) mujore për një shfrytëzues RTK	2
60.	5.2, Tarifa një (1) vjetore për një shfrytëzues RTK	9
70.	5.1, Regjistrimi fillestar i një shfrytëzuesi	13
80.	4.8, Nxjerrja e koordinatave për një pikë detale	95
90.	4.6.1, Printimi A4 (bardhë-zi)	110
91.	4.6, Printimi A4 kolor	7
92.	4.5, Printimi A3 kolor	34
93.	3.5, Kadastë-info për ngastër	16
94.	3.2, Transformimi i koordinatave	126
95.	2.24, Harta e Kosovës me kufijë të ZK-ve e shtypur në përpjesë1:200000	2
96.	2.21, Parcela vektor (Shp file, DWG)	17
97.	2.15, CD disku kompakt	8

1.4 PROKURIMI PUBLIK

AKK brenda 15 ditëve pas miratimit të buxhetit për vitin fiskal 2020 ka përgatitur dhe dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Planifikimin Final të Prokurimit, duke u bazuar në kërkesat e njëjësive kërkuese të aprovuara nga personat përgjegjës për buxhet dhe nga ana e Drejtorit Ekzekutiv.

Planifikimi i prokurimit ka qenë konform buxhetit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës për vitin fiskal në fjalë. Bazuar në planifikimin final të prokurimit, AKK ka zhvilluar 11 aktivitete të prokurimit. Secili proces i prokurimit është administruar përmes këtyre hapave në vijim:

- Planifikimi i prokurimit,
- Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës,
- Përcaktimi i procedurës së prokurimit,
- Përgatitja e dosjes së tenderit, publikimi, hapja dhe vlerësimi i tenderëve,
- Dhënia, nënshkrimi dhe menaxhimi i kontratës.

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, AKK ka paraqitur të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale, të paraqitura në tabelën në vijim.

Prokurimi 2020			
Nr. ren	Përshkrimi i kontratës, Mallra dhe shërbime	Shuma	Data
1.	Mirëmbajtja e Sistemit të Alarmit dhe Kamerave	760.00€	26.05.2020
2.	Mirëmbajtja e sistemit TI (Aklimatizim dhe UPS, në dhomën e serverëve)	21.401,60€	08.07.2020
3.	Botimi i Kornizës së punës Nr. AKK 2020 / 01, Udhëzuesi për RIK dhe KN si dhe Udhëzuesi për procedurat për regjistrimin e pronës në Kadastër	1.568,60€	28.08.2020

4.	Kartelat identifikuese për gjeodetë dhe pllakat për pikat e vjetra nivelimit	980,00€	15.09.2020
5.	Dizajnimi i llogos së Agjencisë Kadastrale të Kosovës	-	Llogoja është siguruar në formë të donacionit (pa pagesë).
7.	Rregullim/ servisim i veturës zyrtare të AKK-së	987.11€	19.10.2020
8.	Përkthim dhe Shtypje të Monografisë për 20 vjetorin e AKK-së	1890,00€	08.12.2020 Kontrata ka përfunduar pa rezultat (kompania nuk ka sjellur asnjë dokumentacion dhe produkt të kërkuar sipas kontratës).
9.	Furnizim me maska dhe dezinfektues	980.00€	24.11.2020
10.	Furnizim me mirënjohje dhe dekorata me rastin e 20 vjetorit të AKK-së	975.00€	27.11.2020
11.	Furnizim me material zyrtar – me rastin e shënimit të 20 vjetorit të themelimit të AKK-së	990.00€	03.12.2020

Nr. ren	Përshkrimi i kontratës	Shuma	Data e lidhjes së kontratës
1.	Zgjerimi i qendrës së të dhënave (HW+SW)	-	Anulimi i aktivitetit të prokurimit (nuk ka arritur asnjë ofertë).

2. AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE TEKNIKE DHE PROFESIONALE

2.1. PROJEKT LIGJI PËR KADASTËR TË PRONAVE TË PALUAJSHME

Përmes hartimit të Projekt Ligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme synohet të eliminohen mangësitë ekzistuese, të cilat në të kaluarën kanë paraqitur problem në realizim të të drejtave pronësore.

Me Projekt Ligjin për Kadastër janë definuar shume çështje, përfshi integrimin e dispozitave të dy ligjeve ekzistuese (Ligjin Nr.04/-L-013 për Kadastër dhe Ligjin me Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme) dhe organizimi vertikal duke bashkuar AKK-në dhe 38 ZKK-të në një institucion të integruar, me një strukturë vertikale të menaxhimit.

Në aspektin profesional ky projektligj rregullon tre elemente themelore të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm dhe avancimin e fushës së kadastrit në veçanti dhe proklamimin e të drejtave pronësore në përgjithësi.

Elementet themelore që ky projektligj i trajton dhe rregullon janë:

- Procedura e unifikuar administrative në ZKK, pasi që aktualisht ekzistojnë dy ligje (Ligjin Nr.04/-L-013 për Kadastër dhe Ligjin me Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme), ndërsa me këtë projektligj, do të kemi një procedurë unike dhe të integruar në një sistem,
- Organizimi vertikal i Zyrave Kadastrale Komunale, duke u bazuar në sistemin e shteteve të rajonit (Maqedonia e Veriut, Mali Zi, Shqipëria) si dhe shteteve evropiane (Holanda, Norvegjia etj) dhe
- Financimi i AKK të sigurohet nga të hyrat vetanake, e të cilat qëllim kryesor do të kenë mbulimin e shpenzimeve, mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemit kadastral të Kosovës.

Elementet sekondare profesionale që ky projektligj trajton dhe rregullon, e të cilat janë vlerësuar lartë, të mirëpritura si dhe të domosdoshme, janë:

- Pararegjistrimi i objektit ndërtimor bëhet sipas lejes ndërtimore në pajtim me ligjin përkatës për ndërtim, duke shënuar lejen ndërtimore, gabaritin e objektit dhe etazhitetin;
- Lejimi i qasjes së institucioneve publike qendrore, lokale dhe subjekteve me autorizime publike në të dhënat nga kadastra për shfrytëzim për nevoja të tyre;

- Qarkullimi elektronik juridik dhe dokumenti elektronik, pas rregullimit me ligj të veçantë dhe
- Kompetencat shtesë për Komisionin e Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale.



Ekspertët e AKK-së, diskutime përfundimtare për ligjin e ri për kadastrë



Takim i grupit punues për finalizimin e ligjit të ri për kadastrë

2.2. PROJEKT LIGJI PËR KRIJIMIN E INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE TË INFORMACIONIT HAPËSINOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Politikat për mjedisin duhet të synojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e situatave në fusha të ndryshme.

Për më tepër informacioni hapësinor është i nevojshëm për hartimin dhe zbatimin e këtyre politikave, të cilat duhet të integrojnë kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Në mënyrë që të arrihet një integrim i tillë, është e domosdoshme të krijohen mekanizmat e koordinimit në mes të përdoruesit dhe ofruesit të informacionit, në mënyrë që të dhënat dhe njohuritë nga sektorët e ndryshëm mund të kombinohen. Krijimi infrastrukturës kombëtare të informacioneve hapësinore për Republikën e Kosovës është obligim që del nga legjislacioni i veçantë ndërkombëtar, përkatësisht Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për krijimin e Infrastrukturës për informacione hapësinore në Bashkimin Evropian (INSPIRE) Nr.2007/02, e që është obligim për vendet e Bashkimit Evropian dhe ato që në të ardhmen e pretendojnë atë anëtarësim. Në këtë infrastrukturë do të jenë të gjitha të dhënat e grumbulluara nga të gjitha institucionet e veçanta në mënyrë që të përdoren më lehtë nga të gjitha palët.

Kjo do të arrihet duke përcaktuar përgjegjësitë e të gjitha institucioneve përgjegjëse të Republikës së Kosovës, ndërsa bashkërendimin sipas Ligjit për Kadastër do ta bëjë AKK. Me këtë Projekt Ligj përcaktohen rregullat e përgjithshme për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës, për jetësim të politikave hapësinore, mjedisore dhe aktiviteteve të cilat mund të kenë ndikim në to.

Me këtë Projektligj:

- mundësohet krijimi, mbledhja, si dhe shkëmbimi i informacioneve të centralizuara me vendet tjera, sipas praktikave të Bashkimit Evropian;
- bëhet përcaktimi i qartë i përgjegjësi të strukturave qeverisëse të Kosovës, si dhe i kompetencave për krijimin, grumbullim dhe shkëmbim të informacioneve hapësinore në Republikën e Kosovës;
- krijohet mundësia për përcaktim të qartë të kriterëve për krijimin e informacioneve, meta të dhënave si pjesë të infrastrukturës kombëtare të të dhënave hapësinore për Republikën e Kosovës.

Të dhënat hapësinore janë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme për Republikën e Kosovës. Shumë institucione krijojnë të dhëna hapësinore në lëmi të ndryshme për të cilat janë kompetente dhe përgjegjëse. Këto të dhëna hapësinore krijohen nga sfera e planifikimit hapësinor, banimit, bujqësisë, pylltarisë, kadastrit, minierave, infrastrukturës, statistikave dhe fushave tjera të administrimit të tokës.

Të dhënat përgatiten në formate të ndryshme që shpesh ka vështirësi në këmbimin dhe përdorimin e tyre nga institucionet e ndryshme të Kosovës por edhe atyre ndërkombëtare që punojnë dhe veprojnë në Republikën e Kosovës.

Prandaj është shumë e domosdoshme që të dhënat që krijohen nga institucionet e ndryshme të sistemohen në një bazë të të dhënave (Gjeoportali për IKIH) që do ta përbëjnë Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore për Republikën e Kosovës, e cila do të mirëmbahet nga AKK.

Objektivi kryesor i projektligjit për IKIH është përcaktimi i qartë i përgjegjësisë dhe kompetencave të Institucioneve të Republikës së Kosovës që merren me krijimin e të dhënave hapësinore dhe përcaktimi i kriterëve për krijimin e të dhënave që do të jenë pjesë e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinore për Republikën e Kosovës.



Konferencë regionale në kuadër të projektit SPATIAL II që konsiston me harmonizimin e të dhënave hapësinore të shteteve të regionit me ato të BE-së

2.3. PROJEKT RREGULLORJA PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË KADASTRALE TË KOSOVËS

Projekt Rregullorja e re ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ku trajton organizimin e zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, të departamenteve dhe divizioneve. Ri-shikimi i strukturave ekzistuese është bërë sipas departamenteve dhe divizioneve.

Kjo iniciativë për rregullore të re vjen si rezultat i: a) Dinamikës së re për të përmirësuar qasjen apo mënyrën e punës dhe (b) Nevojave për t’ju përshtatur ndryshimeve të brendshme, si dhe obligimi që del pas hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, përkatësisht neni 12, i cili përcakton se: *“Të gjitha Institucionet e Administratës Shtetërore, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara të hartojnë Rregulloret përkatëse për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në afat kohor prej gjashtë (6) muajsh dhe t’i paraqesin për miratim.”*

Rishikimi i legjislacionit dhe politikave për kadastër përbën pjesë fillestare të procesit të rishikimit dhe riorganizimit të Agjencisë, si dhe ndryshimi i legjislacionit sa i përket organizimit dhe funksionimit të Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe përcaktimit të Standardeve të Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura.

2.4. UDHËZIMI ADMINISTRATIVE NR. 09/2020 PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTAVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME



Moment nga nënshkrimi i Udhëzimit Administrativ për Tarifatat e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme

Si rezultat i ngritjes së numrit të produkteve dhe shërbimeve që AKK u ofron institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe si rezultat i avancimit të mënyrës së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve kadastrale, respektivisht kalimi i ofrimit të të dhënave nga forma klasike (CD, letër, email) në ofrim të avancuar në rrjet e përmes ueb shërbimeve, është paraqitur nevoja për nxjerrjen e një akti të ri nënligjor për përcaktimin e tarifave për këto shërbime të reja. AKK, pas një pune disa mujore ka arritur që të draftoj Udhëzim Administrativ për Tarifatat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, i cili është nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit më datë 12.11.2020 dhe ka hy në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit, me të cilin është shfuqitur Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2014 për tarifatat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme.

Me këtë udhëzim administrativ është përcaktuar niveli i tarifave për shërbimet e ofruara për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme, ndërsa dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për AKK, ZKK dhe parashtuesit e kërkesave për shërbime dhe produkte. AKK me rastin e përpilimit të këtij udhëzimi administrativ, ka mbuluar tarifat për të gjitha shërbimet që ofrohen nga ZKK dhe nga AKK, e në mënyrë të veçantë çështjet si vijon:

- Tarifa për krijimin e qasjes për shërbime online,
- Mirëmbajtja vjetore për shërbimet e ofruara online,
- Tarifa për verifikimin e informacioneve,

ZKK apo AKK është e obliguar që pas çdo ndryshimi në Regjistër të e pajisë palën me certifikatë pronësie dhe kopje plani pa pagesë. Niveli i tarifave të shërbimeve të parapara me këtë Udhëzim Administrativ reflekton koston dhe kohën e kryerjes së shërbimeve kadastrale.

Gjithashtu ky udhëzim do të mundësojë edhe implementimin e marrëveshjeve që AKK së fundmi i ka nënshkruar me palë të ndryshme të interesit për mundësinë e ofrimit të shërbimeve online përmes ueb shërbimeve, si me Odën e Përmbauesve, Odën e Noterëve, Agjencinë Kundër Korrupsion, Policinë e Kosovës, Njësinë për Inteligjencë Financiare, Këshillin Prokurorial, Këshillin Gjyqësor e të tjera.

2.5 KORNIZA E PUNËS NR. AKK 2020/01 PËR MATJE, KRIJIM DHE REGJISTRIM TË NJËSIVE KADASTRALE (PARCELË, NDËRTESË DHE PJESË TË NDËRTESËS)

Reformat ligjore të ndërmarra nga AKK gjatë fundit të vitit 2019, respektivisht hyrja në fuqi e gjashtë Udhëzimeve Administrative, pos që kanë avancuar administrimin e tokës në përgjithësi, të njëjtat kanë rezultuar edhe në ndryshimin e mënyrës së kryerjes së punëve profesionale nga Agjencia Kadasrale e Kosovës, ZKK, kompanitë gjeodete të licencuara dhe gjeodetët e licencuar.

Pas hyrjes në fuqi të këtyre udhëzimeve administrative është paraqitur nevoja për avancimin e kornizave profesionale të punës në përputhje me ndryshimet e imponuara nga avancimi i kornizës ligjore. AKK ka hartuar dokumentin gjithëpërfshirës profesional, i cili do të shërben si udhërrëfyes i unifikuar për të gjithë profesionistët të përfshirë në fushën e regjistrimit të pronës, kadastrës dhe gjeodezisë.

Përndryshe, dokumenti i hartuar është karakterizuar nga gjithëpërfshirja profesionale e të gjitha palëve të interesit të cilët merren me çështje kadastrale. Në ambientet e AKK-së janë organizuar disa punëtori me pjesëmarrje të 19 ekspertëve nga AKK, ZKK, Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës si dhe gjeodetë të licencuar e ngjashëm.

Komentet, sygjerimet dhe përfundimet e nxjerrura nga këto puntori u trajtuan dhe harmonizuan nga operatori ekonomik dhe të njëjtat u prezantuan në punëtorinë e rradhës e mbajtur në Shkodër, me pjesëmarrje të palëve të njëjta të interesit. Kjo puntori shërbeu për hapjen edhe të shumë temave të tjera profesionale të cilat u trajtuan dhe zënë vend në draftin e kornizës së punës.

Pas përpilimit të draftit final Korniza e Punës është prezantuar në shikim publik përmes webfaqes së AKK-së dhe faqes zyrtare në rrjete sociale, poashtu vegëza e publikimit u është dërguar me email të gjithë zyrtarëve të AKK-së, Zyrave Kadastrale Komunale dhe gjeodetëve të licencuar për dhënien e komenteve dhe sygjerimeve finale.

Pas trajtimit të të gjitha komenteve të pranuar dhe finalizimit të Kornizës së Punës të cilën e karakterizoi gjithëpërfshirja profesionale, ajo hyri në fuqi në muajin Prill të vitit 2020 me çka u ofruan udhëzime konkrete profesionale Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Zyrave Komunale Kadastrale, gjeodetëve/kompanive gjeodete të licencuara, operatorëve ekonomik dhe u krijua një standard unik për të

gjitha procedurat dhe dokumentacionin për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale duke filluar që nga kërkesa e palës për shërbime kadastrale e deri tek regjistrimi i të drejtave pronësore në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK).



Ballinat e Kornizës së Punës dhe Doracakëve

2.6 DORACAKU PËR RINDËRTIMIN E INFORMACIONEVE KADASTRALE

Bazuar në Ligjin për Kadastër dhe Ligjin për Regjistrin e të Drejtës së Pronës së Paluajtshme në Republikën e Kosovës, AKK është përgjegjëse për Kadastër dhe është kompetente për mbikëqyrjen e përgjithshme të veprimtarisë kadastrale dhe të nxjerrjes së akteve tjera nënligjore lidhur me veprimtarinë kadastrale, kurse ZKK dhe gjeodetët e licencuar/kompanitë gjeodete të licencuara janë të obliguar të zbatojnë të gjitha Udhëzimet Administrative dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga Ministria respektivisht AKK.

Për mirëmbajtjen e kadastrit dhe regjistrin të pronës së paluajtshme, AKK ka krijuar Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), që është një sistem për mbledhjen, përpunimin dhe distribuimin apo shpërndarjen e të dhënave mbi tokën. Sipas legjislacionit në fuqi përmes këtij sistemi, përveç mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit, AKK në bashkëpunim me ZKK-të ka zhvilluar projekte për Rindërtimi të Informacioneve Kadastrale (regjistrimit sistematik) me qëllim të azhurnimit dhe plotësimit të të dhënave ekzistuese me gjendjen faktike në terren.

Duke patur parasysh avancimet në aspektin ligjor gjatë vitit 2019, me nxjerrjen e 6 Udhëzimeve Administrative nga fusha e Kadastrit dhe nxjerrjen e kornizës së punës, po ashtu duke patur parasysh edhe zhvillimet dhe ndryshimet në aspektin teknik të SIKTK, ka lind nevoja që Doracaku për procesin e Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale të azhurnohet dhe plotësohet sipas zhvillimeve të fundit.

Gjithëpërfshirja profesionale karakterizoi poashtu edhe përpilimin e këtyre doracakëve, pasi që komente dhe sygjerime përveç nga ekspertë të AKK-së janë ofruar edhe nga palë të tjera profesionale. Fatkeqësisht për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia e shkaktuar nga COVID 19, për këtë doracakë nuk janë mbajtur punëtori me pjesëmarrje fizike por gjithsesi janë mbajtur takime të shumta virtuale përmes platformave online.

Në këtë doracakë janë pasqyruar të gjitha aktivitetet që ndërmerren në kuadër të projektit duke filluar që nga faza fillestare e përzgjedhjes së zonave kadastrale për përfshirje në projekt, informimi publik, punët e terrenit, kontrollat e kualitetit, futja e të dhënave në SIKTK e deri tek finalizimi i projektit dhe shpallja e projektit si i përfunduar.

Me qëllim të zhvillimit sa më të suksesshëm të projekteve të RIK dhe që përfitimi i qytetarëve të jetë sa më i madh, ky doracak do të jetë udhërrëfyes për ekspertë dhe zyrtar profesional nga AKK, ZKK, operatorët ekonomik dhe akterët tjerë të interesit, që me saktësi të zbatojnë procedurat gjatë realizimit të projekteve të rindërtimit të informacioneve kadastrale.



Takim me përfaqësues të Odës së Ndërmjetësuesve, me qëllim të përfshirjes së tyre në proces të Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale



Ekip gjithëpërfshirës nga AKK, ZKK dhe Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës të përfshirë në krijimin e doracakëve profesional

2.7 DORACAKU PËR KADASTRIN E NDËRTESAVE

Toka së bashku me ndërtesat dhe pjesët e ndërtesave, është një nga pasuritë më të rëndësishme financiare për çdo vend. Çdo investim është në një mënyrë i varur nga toka dhe prona e paluajtshme. Pa sigurinë e titullarit për tokën dhe ndërtesat është e vështirë të sigurohen fonde investimi dhe kapital për biznes.

Siguria juridike e pronësisë së tokës dhe ndërtesave lehtëson financimin e investimeve të bazuara në hipotekë për bizneset e vogla dhe të mesme dhe mbështet infrastrukturën fizike të pothuajse të gjitha operacioneve tregtare. Pasi që zhvillimi i kadastrit dhe procedurave kadastrale për regjistrimin e ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave është një proces dinamik dhe pas reformave që janë ndërmarrë gjatë vitit 2019 me nxjerrjen e gjashtë Udhëzimeve Kadastrale në fushën e kadastrit, ka lindur nevoja që Doracakun për procesin e Kadastrit të Ndërtesave të azhurnohet dhe plotësohet sipas avancimeve të fundit teknike dhe ligjore si dhe zhvillimeve në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK).

Në këtë doracak janë të përfshira të gjitha fazat e realizimit të projektit për kadastrin e ndërtesave që nga planifikimi i Zonës Kadastrale, informimin publik, fushatën e matjeve, përpunimin e të dhënave, kontrollën e kualitetit, shikimin publik dhe zyrtarizimi i të dhënave të fituara nga projekti.

Me këtë Doracak do të ndihmohet procesi i mëtutjeshëm i regjistrimit të ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave, duke lehtësuar dhe unifikuar procedurat për këtë regjistrim. Ky doracak do të ndihmojë të gjithë ekspertët dhe zyrtarët profesional që do të përfshihen në këtë proces si nga sektori privat, po ashtu edhe nga ai publik, që me saktësi dhe lehtësi të zbatojnë procedurat në këtë proces.



Takim pune me gjeodetë për përpilimin e doracakëve profesional

2.8 UDHËZUES PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME NË KADASTËR

Hyrja në fuqi e udhëzimeve administrative për regjistrimin e pronës si dhe krijimi i kornizës së punës për matjen, krijimin dhe regjistrimin e njësive kadastrale ka pasur ndikimin shumëdimensional profesional e shoqëror.

Këto reforma ligjore, profesionale e teknike avancuan administrimin e tokës, ngritën sigurinë e të drejtave pronësore, ngritën kualitetin e produkteve dhe shërbimeve pronësoro-juridike, lehtësuan procedurat për regjistrimin e të drejtave pronësore, avancuan gjithpërfshirjen në shfrytëzim të të drejtave pronësore, shmangën burokracinë administrative, ngritën transparencën, minimizuan mundësitë për pagesa joformale e korruptive, e ngjashëm. Njëherësh këto reforma ndikuan edhe në ndryshimin e qarkut të punës për ekspertët dhe teknikët e përfshirë në regjistrimin e të drejtave pronësore nëpër ZKK, gjeodetët e licencuar, krejt me synim që të kemi një shërbim efikas dhe të drejtë, ku pala është gjithmonë dhe kudo në qendër të ofrimit të shërbimit publik.

Me qëllim të unifikimit të procedurave për regjistrimin e pronës në tërë territorin e Republikës së Kosovës, AKK e ka krijuar Udhëzuesin për procedurat e regjistrimit të pronës së paluajtshme në kadastër i cili ofron udhëzime dhe përgjigje të qarta për procedurat e regjistrimit të kategorive të ndryshme të të drejtave pronësore, përgjegjësitë e palëve të përfshira në procedurë (gjykata, noterë, gjeodetë etj.), afatet ligjore, organet vendimmarrëse dhe ato ankimore. Një proces i tillë do të ndikonte në uljen e kohës për përgatitjen dhe trajtimin e kërkesave nga përpilimi, pranimi e deri në përfundimin e tyre.


Me këtë doracak janë të sqaruara të gjitha procedurat e regjistrimit të të drejtave pronësore dhe përshkrimi i të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për secilin proces duke filluar nga procesi i zhvilluar te Zyra Noteriale apo në Gjykatë, regjistrimit të të drejtës në ZKK e deri te paisja me Certifikat pronësore dhe Kopje plani

Udhëzuesi për procedurat e regjistrimit të pronës së paluajtshme në kadastër synon tu japë përgjigje të qarta në pyetjet e zakonshme të secilës palë të interesuar për procedurën e regjistrimit në kategori të ndryshme të të drejtave pronësore, përgjegjësitë e palëve të përfshira në procedurë (gjykata, noterë, gjeodetë etj.), afatet ligjore, organet vendimmarrëse dhe ato ankimore.

Ky udhëzues ndihmon në unifikimin e procedurave të punës së të gjitha ZKK-ve

në vend, duke integruar këto procedura në rrjedhën e përditshme të punës së ZKK-ve, udhëzon secilin të interesuar në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm për azhurnime në kadastrë, për hapat që duhet ndjekur, për afatet kohore të realizimit të kërkesave të tyre, etj. Ky udhëzim është tentuar të bëhet në formën më të lehtë dhe të kuptueshme përmes organogramave ku tregohet qartë rrjedha e secilit prej proceseve të caktuara.

Hartimit të këtij udhëzuesi i ka paraprirë edhe faza e diskutimit publik edhe konsultimeve profesionale, përmes inkuadrimit të përfaqësuesve të Zyrave Kadastrale Komunale dhe gjeodetëve të licencuar.



Broshura të prodhuar nga udhëzuesi

2.9 DORACAKU PËR SISTEMIN E ADRESAVE

Në kuadër të reformave ligjore brenda AKK-së dhe nevojës për ndryshimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe doracakëve teknik që rregullojnë fushën e adresave, gjatë vitit të kaluar kanë hyrë në fuqi pesë Udhëzimeve Administrative dhe si nevojë e ndryshimeve ligjore është bërë edhe avancimi i doracakakut për sistemin e adresave, e që së bashku kanë ngritur kualitetin e adresave dhe rrjedhimisht edhe kualitetin e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i reformës ligjore dhe teknike ka qenë që ti adresojë problemet dhe sfidat dhe të eliminojë ngecjet në mirëmbajtjen më efikase të Sistemit të Adresave nga ana e Komunave, ndërsa konkretisht janë avancuar çështjet e riemërtimit të Zonave të Qarkullimit Publik (ZQP) me qëllim të tejkalimit të sfidave që kanë ardhur nga ndryshimet e shpeshta të adresave rrugëve e ngjashëm.

Me hyrjen në fuqi të këtyre udhëzimeve administrative është ndaluar riemërtimi i ZQP-ve për një periudhë kohore prej 10 vjet përpos në disa raste të veçanta, janë obliguar institucionet që të shfrytëzojnë adresat zyrtare, është rregulluar çështja e barazisë gjinore me rastin e emërtimit të ZQP dhe është definuar formati unik i tabelave të emrave dhe numrave të adresave. Me këtë doracak janë të sqaruara të gjitha procedurat teknike sa i përket sistemit të adresave, me qëllim të lehtësimit të punës së institucioneve dhe individëve të përfshirë në mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemit të unifikuar të adresave. Ekspertët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës draftuan doracakun e sistemit të unifikuar të adresave, i cili poashtu iu nënshtrua diskutimit publik, kryesisht diskutimit në mes zyrtarëve të AKK-së dhe zyrtarëve të Komunave përgjegjës për mirëmbajtje të adresave në komunat përkatëse. Deri në përpilimin e versionit final të këtij doracaku u mbajtën disa takime virtuale përmes platformave online dhe 3 takime në ambiente të AKK-së duke respektuar të gjitha masat me rastin e pandemisë.

Duke dhënë udhëzime të qarta dhe konkrete përmes publikimit të këtij doracaku u lehtësua puna e institucioneve dhe individëve të përfshirë në mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemit të unifikuar të adresave në përgjithësi.

Si rezultat i këtyre dokumenteve, AKK ia ka dalë që të mbulojë zbrazëtirat teknike e profesionale me të cilat në të kaluarën janë përballuar profesionistët e fushës dhe qytetarët.

2.10 UDHËZUESI DHE QARKORJA NR.1 PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE

AKK përmes zyrtarëve të saj ka ofruar mbështetje të rregullta Ministrinë së Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), përkatësisht Departamentit të Ndërtimit në fushën e trajtimit të ndërtimeve pa leje-legalizimit. AKK ka organizuar një mori takimesh me përfaqësuesit e MEA, USAID-it dhe Komunave, përkatëse për sqarimin e çështjeve kadastrale lidhur me regjistrimin e objekteve në procedurën e legalizimit. Vlen të theksohet se ka pasur takime edhe në nivel të lartë me Shoqatën e Bankave të Kosovës sa i përket mënyrës së legalizimit të objekteve ku pronari i objektit paraprakisht e ka hipotekuar parcelën ku gjendet objekti i cili trajtohet me proces të legalizimit.

Gjithashtu janë diskutuar dhe është gjetur zgjidhje adekuate duke u bazuar në kornizën ligjore kadastrale dhe atë të legalizimit, çështjet dhe problemet që kanë lindur në ZKK gjatë ekzekutimit të gjendjes faktike në terren, ku AKK gjithmonë ka shqyrtuar kërkesat e tilla dhe ka dhënë përgjigje, e në shumicën e rasteve zgjidhje konkrete me qëllim që projekti i legalizimit të mos ndërpritet dhe të arrij cakun në legalizimin dhe regjistrimin e sa më shumë objekteve të ndërtuara pa leje.

AKK, përkatësisht Drejtoria e Kadastrit dhe Drejtoria Ligjore, ka qenë boshti kryesor i draftimit të Udhëzuesit-Doracakut për legalizim i cili është draftuar dhe përpunuar nga USAID dhe MEA, e që i njëjti është bërë me qëllim të sqarimit të problemeve që kanë lindur gjatë zbatimit në terren të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij.



Takim pune me USAID dhe ZKK Prishtinë për Qarkoren

3. SHËRBIMET DHE PËRKRAHJA NGA AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

3.1 SHËRBIMET KADASTRALE OFRUAR INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Të dhënat kadastrale që ofron AKK, për shumë institucione të vendit janë të dhëna kyqe dhe shumë të rëndësishme nga të cilat mvaret edhe realizimi i objektivave të tyre. Gjatë vitit 2020, vit i karakterizuar nga pandemia e shkaktuar nga Covid19, gjithsesi kishte kërkesa për të dhëna kadastrale nga institucionet e vendit, u ky numër i kërkesave arriti në gjithsejtë 655. Kërkesat e parashtruara nga institucionet për të dhëna kadastrale janë të listuara në tabelën e mëposhtme, të cilat kërkesa nëse nëse krahasohen me vitin paraprak janë në një numër prej 50% më pak.

Numri rendor	Institucioni	Nr. i kërkesave
1	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	15
2	Agjencia Kundër Korrupsionit	10
3	Agjencia Kosovare e Privatizimit	5
4	Administrata Tatimore e Kosovës	198
5	Avokati i popullit	1
6	Azhurnime ne SIKTK - Komunat Veriore	44
7	Certifikata për komunat veriore	240
8	Certifikata që nuk posedon pronë	4
9	Departamenti i Hetimeve Tatimore	1
11	Gjykata Supreme	1
12	Gjykata Speciale	2
13	Gjykata Themelore Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Prizren	8
17	Gjykata Themelore Podgoricë	1
18	Hekurudhat e Kosovës	1
19	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	3
20	Azhurnime në SIKTK - Komisioni për RIK	4
21	Përmbarues Privat	51
22	Policia e Kosovës	62
23	Prokuroria Themelore Ferizaj	2
24	Prokuroria Themelore Gjakovë	1
25	Prokuroria Themelore Prizren	1
	Gjithsej	655

3.2 ELABORATET E SHPRONËSIMIT DHE KËRKESAT E PALËVE

Vlen të ceket se që nga data 10.03.2017 Agjencia Kadastrale e Kosovës ka marr përsipër që të bëj kontrollin e kualitetit në aspektin teknik për elaboratet e shpronësimit, proces i cili ka vazhduar edhe në vitin 2020 duke lehtësuar në masë punën e Departamentit e Shpronësimit.

Gjithashtu si organ i shkallës së dytë AKK pranon kërkesa dhe ankesa nga persona fizik dhe juridik të cilët pretendojnë që ZKK-të kanë vendosur jo në mënyrë të duhur për lëndët e tyre apo janë të pakënaqur me shërbimet dhe përgjigjet që u janë ofruar. Gjatë vitit 2020 kemi pranuar gjithsejtë 278 kërkesa që kanë pasur të bëjnë edhe me aspektin grafik edhe me atë tekstual të të dhënave kadastrale.

Po ashtu si institucioni i vetëm që bënë transformim zyrtar të koordinatave nga sistemi koordinativ paraprak i përdorur në Kosovë FRYREF në sistemin aktual koordinativ KosovaREF, gjithsejtë kemi pranuar 59 kërkesa për transformim të koordinatave në mes këtyre sistemeve koordinative.

3.3 SHËRBIMET JURIDIKE

Bazuar në Ligjin Nr.04/-L-013 për Kadastër dhe Ligjin me Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Drejtoria Ligjore është përgjegjëse për shqyrtimin e të gjitha ankesave dhe kërkesave të parashtruara nga personat fizik dhe juridik si dhe nga institucionet publike, si organ i shkallës së dytë, ndaj vendimeve të organit të shkallës së parë.

Për tri Komunitet e Kosovës, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan, për shkak të mos funksionimit të ZKK, si nivel lokal në realizimin e përgjegjësi të deleguara, bazuar në Ligjin Nr.04/-L-013 për Kadastër, me qëllim të ofrimit të shërbimeve, është vendosur që AKK të ushtroj kompetencat si organ i shkallës së parë. Bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjet e cekura më lartë, AKK përveç çështjeve të përgjithshme ka shqyrtuar kërkesa/ankesa si dhe janë realizuar përfaqësime në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Në tabelën në vijim janë paraqitur të përbledhura statistikisht rreth shërbimeve juridike të ofruara nga Drejtoria Ligjore gjatë vitit 2020.

Ankesa si shkallë e dytë	Përfaqësime në gjykatë	Kërkesa si shkallë e parë	Përgjigje në padi	Vlerësim i ligjshmërisë	Total
688	80	54	32	20	874

3.4 SHËRBIMET PËR QYTETARËT NGA ZYRAT KADASTRALE KOMUNALE DHE AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

Agjencia Kadastrale e Kosovës menaxhon dhe mirëmban regjistrin mbi të drejtat e pronës së paluajtshme. Përmes Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Tokave në Kosovë-SIKTK, nga ZKK-të dhe AKK gjatë vitit 2020 janë aprovuar gjithsejtë 52,636 lëndë dhe janë lëshuar 112,570 certifikata, prej të cilave 5,289 janë certifikata/vërtetim për mosposedim të pronës. Nga gjithsej 112,570 Certifikata të pronësisë, prinë Prishtina me 13,322 certifikata të pronësisë të lëshuara, ndërsa e fundit është Zveçani me 56 certifikata të pronësisë të lëshuara.



Në nivel të Kosovës janë aprovuar gjithsejtë 12,209 shitblerje, ku numri më i madh i tyre ka qenë në Prishtinë me 1,346.



Gjithashtu Prishtina prinë edhe me hipoteka të aprovuara gjithsejtë 624 kundrejt numrit të përgjithshëm prej 2,471 hipoteka. Intensiteti i kërkesave për regjistrim të hipotekave ka qenë më i madh gjatë muajit Shkurt, muaj në të cilin janë regjistruar 285 hipoteka, ndërsa numri më i vogël është gjatë muajit Prill me 63 hipoteka të regjistruara.



Gjatë vitit 2020 në SIKTK për gjithë territorin e Kosovës janë krijuar gjithsej 1,650 lëndë për bashkim të parcelave, ku prinë Prishtina me 233 lëndë. Lloj tjetër i lëndës i regjistruar në SIKTK gjatë vitit 2020 është edhe lënda për ndarjen e parcelave kadastrale. Gjatë vitit 2020 nga SIKTK për gjithë territorin e Republikës së Kosovës janë krijuar gjithsej 7,018 lëndë për ndarje të parcelave, ku prinë prap Prishtina me 941 lëndë. Intensiteti i kërkesave është më i madh gjatë muajit Tetor, muaj në të cilin janë aprovuar 905 kërkesa për ndarje të parcelave, ndërsa numri më i vogël është gjatë muajit Prill me 137 aprovime për ndarje të parcelave.



3.5 OFRIMI I QASJEVE NË TË DHËNA KADASTRALE PËR INSTITUCIONE PUBLIKE

Me qëllim të lehtësimit së procedurave dhe ofrimit të qasjes më të shpejtë në të dhëna kadastrale për institucione publike, apo kalimi nga forma “tradicionale” e ofrimit të të dhënave përmes CD apo kopjeve fizike, në formën e avancuar përmes ofrimit të qasjes në të dhëna në kohë reale përmes ueb shërbimeve Agjencia Kadastrale e Kosovës paraprakisht ka zhvilluar sistemin UCWSS për qasje të limituar në Regjistrin e të drejtave mbi Pronën e Paluajtshme (RDPP) dhe pastaj ka identifikuar institucionet e interesit. Para fillimit të ndërveprimit mes institucioneve përkatëse AKK-ja ka nënshkruar Memorandume bashkëpunimi me të gjithë akterët e të cilat marrëveshje kanë pasur për qëllim specifikimin e roleve dhe përgjegjësi gjatë procesit të operimit me qasje të limituar në RDPP. Marrëveshjet e nënshkruara kanë qenë të shoqëruara edhe me marrëveshje teknike për implementimi të aktiviteteve të specifikuara, e që kryesisht kanë pasur të bëjnë me kapacitetet teknike e profesionale të institucioneve.

Vlen të ceket se për shkak të masave të krijuara nga pandemia e shkaktuar nga Covid19 të gjitha trainimet janë mbajtur duke përcjellë rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, pra duke i organizuar trainimet në grupe të vogla apo edhe duke mbajtur trainimet virtuale përmes platformave online.

Statistikat mbi numrin e përdoruesve të trajnuar e të cilëve më pas, u janë ofruar qasje janë si në vijim:

Nr.	Institucioni	Nr. i përdoruesve
1	Oda e përmbauesve të Kosovës	41
2	Oda e Noterëve të Kosovës	59
3	Agjencia e Kosovës për Integjencë	3
4	Agjencia Kosovare e Privatizimit	12
5	Administrata Tatimore e Kosovës	34
6	Njësia për Integjencë Financiare	17
7	Këshilli Prokurorial i Kosovës	11
8	Këshilli Gjyqësorë i Kosovës	2
9	Policia e Kosovës	2
Totali:		181

3.6 SHËRBIMET NGA POZICIONIMI SATELITOR I KOSOVËS – KOPOS

Rrjeti permanent i pozicionimit në Republikën e Kosovës (KOPOS), mbulon tërë territorin e vendit në përcaktimin e pozitës me një saktësi centimetrike në rrafshin horizontal dhe vertikal bazuar në sistemin zyrtar referent KosovaRef01.

Që nga funksionalizimi i këtij shërbimi deri më tani kemi të regjistruar 191 përdorues. Përdoruesit e regjistruar deri më tani janë të profileve dhe fushave të ndryshme, duke filluar nga personat fizik e deri te institucionet qeveritare.

Vetëm në vitin 2020 janë regjistruar 13 përdorues të ri të shërbimeve të KOPOS-it. Përdorimi mesatar ditor i shërbimeve të KOPOS-it është 90 orë, mesatarisht 3300 orë për një muaj dhe numrit mesatar i përdoruesve ditor është mbi 90. Ashtu si edhe viteve të mëparshme, aktivitetet më të mëdha të matjeve nga KOPOS-i janë zhvilluar në Komunën e Prishtinës.

Në tabelën në vijim janë paraqitur disa statistika të shfrytëzimit të KOPOS-it gjatë vitit 2020, në të cilat paraqitet përgjatë muajve numri i shfrytëzuesve të këtij shërbimi dhe koha e shfrytëzimit.

STATISTIKAT 2020		
Muaji	Orë të shfrytëzimit	Shfrytëzues
Janar	2227	173
Shkurt	2551	183
Mars	1941	184
Prill	1736	162
Maj	3052	181
Qershor	3860	195
Korrik	4305	195
Gusht	3833	195
Shtator	4012	187
Tetor	4477	188
Nëntor	3814	194
Dhjetor	2968	183
Gjithsej	35808	2025

Rrjeti permanent i pozicionimit në Republikën e Kosovës në vitin 2020 e karakterizoi edhe realizimi në praktikë i Marrëveshjes për shkëmbimin e të dhënave nga rrjetet permanente gjeodezike KOPOS dhe MAKPOS, respektivisht shfrytëzimin e pikave të rrjetit permanent të Republikës së Kosovës (KOPOS) nga

Republika e Maqedonisë së Veriut dhe shfrytëzimi i pikave të rrjetit permanent të Republikës së Maqedonisë së Veriut (MAKPOS), nga Republika e Kosovës.

Poashtu marrëveshja e njëjtë si me Republikën e Maqedonisë së Veriut u implementua edhe me Republikën e Shqipërisë, përkatësisht marrëveshja për shkëmbimin e të dhënave nga rrjetet permanente gjeodezike KOPOS dhe ALBCORS.

Ky implementim i marrëveshjeve ka mundësuar mbulueshmërinë me sinjal për aktivitete gjeodezike që kryhen në zonat e brezit kufitar mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut përkatësisht Shqipërisë. Kur jemi tek KOPOS-i vlen të theksohet se pandemia dhe masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kanë patur ndikim negativ në kryerjen e shërbimeve profesionale të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara që kjo nënkupton edhe mungesë apo të ardhura të kufizuara.

Pasi që këta të fundit paguajnë kosto financiare për shfrytëzimin e shërbimeve të KOPOS-it, AKK për një periudhë dy mujore ka liruar të gjithë përdoruesit e këtij rrjeti permanent të pozicionit në Republikën e Kosovës nga pagesa për shfrytëzim të rrjetit.



Takim mes AKK dhe homologëve maqedonas për implementim të marrëveshjes KOPOS-MAKPOS

3.7 SHËRBIME NGA GJEPORTALI SHTETËROR

Gjatë vitit 2020 është vazhduar me ritmin e njëjtë të administrimit dhe mirëmbajtjes së Gjeoportali-it si edhe në vitet e kaluara. Mund të themi se në 99.7% të kohës Gjeoportali ka qenë i qasshëm dhe funksional. Gjatë këtij viti Gjeoportali kishte disa probleme të vogla me leximin e të dhënave vektoriale, problem që u rregullua me anë të replikimit të të dhënave nga Pjesa Grafike në Gjeoportali. Edhe gjatë këtij viti është vazhduar me publikimin e të dhënave të ndryshme nga Institucione të ndryshme në Gjeoportali, si dhe me përditësimin e të dhënave aktuale të cilat janë të publikuara në Gjeoportali. Gjatë vitit 2020 është bërë përditësimi i të dhënave të shtresës “Harta Topografike 1:25000”, ku janë përditësuar 17 fleta të Hartave Topografike të cilat kishin pësuar ndryshime. Gjithashtu gjatë këtij viti janë publikuar 7 shtresa të reja në Gjeoportali të cilat janë si në vijim:

Nr.	Emri i shtresës	Institucioni përgjegjës
1.	Stacionet Policore	Policia e Kosovës
2.	Stacionet Policore Kufitare	
3.	Nënstacionet	KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës)
4.	Shtyllat	
5.	Linjë me nivel të tensionit 110kV	
6.	Linjë me nivel të tensionit 220kV	
7.	Linjë me nivel të tensionit 400kV	

4. ZHVILLIME NË SISTEMIN E INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË

Hyrja ne fuqi e Udhëzimeve të reja administrative dhe Kornizës së punës së AKK-së ka paraqitur nevojën e ndryshimeve në disa lëndë në SIKTK e gjithashtu edhe shtimin e funksionaliteteve të reja.

Në kuadër të standardizimit dhe unifikimit të të gjithë dokumentacionit relevant kadastral, të gjitha llojet e aktvendimeve të cilat ZKK i marrin gjatë mirëmbajtjes së rregullt të të dhënave kadastrale janë unifikuar dhe inkuadruar në SIKTK. Inkuadrimi dhe përpilimi i vendimit brenda vetë sistemit ka bërë që të kemi aktvendime të formatit unik në të gjithë Kosovës si dhe në rast të ndryshimeve eventuale në legjislacion, e gjithë përmabajtja e nevojshme kontest i ndryshimit do të unifikohet në të njëjtën formë për të gjitha ZKK-të nga ana e AKK-së.

Një prej ndryshimeve që ka reflektuar edhe në formatin e certifikatës mbi të drejtat mbi pronën e paluajtshme është edhe regjistrimi i etazheve të shtëpive të banimit, duke ofruar mundësinë që për shtëpitë e banimit në certifikatën e pronësisë të paraqiten edhe informacionet për katet dhe sipërfaqen e tyre. Ky ndryshim ka ardhur si kërkesë e grupit punues për trajtimin e ndërtimeve pa leje, ku ndër disa institucione është e përfshirë edhe AKK. do të ndihmojë edhe shumë institucione tjera si bankat për raste të hipotekave, pastaj tatimin në pronë dhe institucione tjera relevante.

Me Kornizën e punës Nr. AKK 2020/01 në kuadër të standardizimit të të gjitha manualeve, regjistrave dhe dokumenteve të tjera janë ristandardizuar edhe formularët për regjistrimin e ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave. Standardizimi i formularëve ka mundësuar që regjistrimi i tyre në SIKTK të realizohet duke thirrur të dhënat direkt nga formulari, procedurë kjo që zyrtarëve të ZKK-ve do tu shkurtojë jashtëzakonisht shumë kohën e azhurnimit dhe do të zvogëlojë mundësinë e gabimeve në regjistrim.

Ndryshime në Kornizën e punës janë bërë edhe në formatin e ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës. Numri i parcelës është larguar nga formati i regjistrimit të ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës.

Kjo rrjedhimisht ka ndikuar edhe në ndryshimin e logjikës së regjistrimit të 9 llojeve të lëndëve në SIKTK, të gjitha ato lëndë që kanë të bëjnë me regjistrimin, modifikimin, ndarjen e bashkimit, e ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave.

Një zhvillim tjetër i nevojshëm për tu realizuar në SIKTK si pasojë e hyrjes në fuqi të Kornizës së punës ka qenë edhe lejimi i bashkimit të parcelave me të drejta të ndryshme. Gjithashtu janë realizuar edhe ndërhyrje në hapa dhe funksionalitete të tjera me qëllim të rritjes së performancës së sistemit dhe shpejtimin të procedurave gjatë azhurnimit. Lista e ndryshimeve të realizuara gjatë këtij viti në SIKTK është listuar në vazhdim:

- Modifikimi i sistemit SIKTK-T për lejimin e bashkimit të parcelave me pronarë të ndryshëm me të drejta të njëjta;
- Modifikimi i sistemit SIKTK-T për lejimin e regjistrimit të servitutit ku dominant janë më shumë persona;
- Modifikimi i sistemit SIKTK-T për të mundësuar regjistrimin e pjesëve të ndërtesës sipas fajllit me një standard/format të caktuar, vendosja e kontrollova të veçanta që mundësojnë ngarkimin, leximin dhe validimin e shënimeve përkatëse nga fajlli;
- Krijimi i mundësisë së bashkimit të parcelave me të drejta të ndryshme (Pronësi, Posedim, E drejta e shfrytëzimit, Qira mbajtje 99 vite, shfrytëzues);
- Në sistemin SIKTK-HK tek pjesët e ndërtesave “ID e llojit të pjesës së ndërtesës” janë shtuar këto dy veçori: Hapësirë e përbashkët, Kati;
- Është krijuar lloji I ri i lëndës Bashkimi i ndërtesave;
- Është krijuar lloji I ri i lëndës regjistrimi i hapsirave të përbashkëta;
- Janë bërë modifikimet e nevojshme në disa lloje të lëndëve si mëposhtë (për mundësinë e ruajtjes së formatit të ri për ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës pa numër të parcelës):
 1. Regjistrimi i ndërtesës,
 2. Regjistrimi i pjesës së ndërtesës,
 3. Modifikimi i ndërtesës,
 4. Modifikimi i pjesës së ndërtesës,
 5. Regjistrimi i ndërtesës së përkohshme,
 6. Modifikimi i pjesës së përkohshme të ndërtesës,

7. Ndarja e ndërtesës,
 8. Ndarja e pjesës së ndërtesës,
 9. Bashkimi i pjesëve të ndërtesave.
- Zhvillimi i modulit për gjenerimin e faturës për taksën sipas udhëzimit administrativë të AKK-se në modulën për regjistrimin e hipotekave nga bankat;
 - Krijimi i lëndës Bashkimi i personave të njëjtë jo vetëm dy por dhe më shumë pronarë për korigjimet e emërtimeve të komunave;
 - Mundësia e regjistrimit të ndërtesës (individuale të banimit ose afarizëm) me destinime/shfrytëzime të veçanta për secilin kat, aty ku shënohet sipërfaqja të prëzgjdhjet edhe shfrytëzimi aktual (banim, afarizëm, garazhë, depo, etj);
 - Tek pjesa e ndërtesë është shtuar mundësia e nën sipërfaqeve, d.m.th. përveç sipërfaqes totale të njësisë të këtë mundësi shënimi të sipërfaqeve përbërëse të saj bazuar në llojin e shfrytëzimit (banim, tarracë, lokal, depo, etj);
 - Sa i përket zhvillimeve në SIKTK edhe gjatë vitit ka vazhduar bashkëpunimi në me Operatorin Ekonomik në administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kadastral SIKTK-SOA. Mund të themi se në 99.99% të kohës SIKTK-SOA ka qenë i qasshëm dhe funksional;
 - Gjatë këtëj viti kompania mirëmbajtëse e sistemeve të SIKTK-SOA ka bërë mirëmbajtjen, zhvillimin e shumë kërkesave të reja ne SIKTK-T;
 - Po ashtu kjo kompani ka bërë vendosjen e versioneve në ambiente testuese dhe reale të cilat janë zhvilluar si rezultat i kërkesave të shumta që i janë drejtuar nga grupi punues i këtëj projekti;
 - Deri më tani në SIKTK-T janë vendosur 20 versione në ambientin real dhe testues, me kërkesa të ndryshme. Po ashtu janë pranuar edhe 18 raporte te mirëmbajtjes se sistemeve nga ana e kompanisë.

4.1 UNIFIKIMI I EMRAVE TË PRONARËVE TË REGJISTRUAR ME EMRA TË NDRYSHËM NË SIKTK

Në Nëntor të vitit 2020 është marr vendim që të fillohet me unifikimin e emërtimeve të komunave në SIKTK, me qëllim të krijimit të një numri unik dhe një emërtimi unik e zyrtarë për secilën komunë, duke krijuar kështu një regjistër më të saktë dhe më të besueshëm, e gjithë kjo në frymën e iniciativës së AKK-së për plotësimin dhe korrigjimin e të dhënave për persona fizik dhe juridik në regjistrin kadastral. Për realizimin e këtij aktiviteti është krijuar grupi punues i përbërë nga ekspertë nga Drejtoria e Kadastrit, Drejtoria Ligjor dhe Drejtoria për Teknologji të Informacionit.

Fillimisht në realizimin e këtij procesi, është kërkuar nga komunat respektive që të përcjellin të dhënat e tyre zyrtare siç janë: Numri Fiskal dhe Emërtimin zyrtarë. Në anë tjetër nga ana e zyrtarëve të AKK-sa janë ekstaktuar dhe janë analizuar të dhënat e të gjitha emërtimeve që kanë përfshirë komunën.

Pas analizës është bërë filtrimi i këtyre të dhënave duke i përzgjedhur për shqyrtim fillimisht vetëm njësitë kadastrale të cilat për titullar kanë komunat dhe të cilat nuk kanë ndonjë destinim (shfrytëzim) tjetër të përcaktuar.

Pasi është bërë përzgjedhja janë përgatitur Regjistrat e Ndërrimeve për secilën komunë, ku të njëjtit fillimisht u janë dërguar për verifikim edhe Zyrave Kadastrale Komunale për një afat të caktuar. Pas kalimit të afatit dhe pranimit të komenteve eventuale, dokumentacionit teknik të përpiluar nga grupi punues për unifikimin e emrave të komunave iu janë bashkangjitur edhe vendimet për kryerjen korrigjimeve në SIKTK.

Në kuadër të gjithë aktivitetit të realizuar për gjithsejtë 38 Komunat e Kosovës janë unifikuar një numër prej 807 emërtimeve, të cilat kanë afektuar 40244 njësi kadastrale.

Numri	Komuna	Nr. i emërtimeve të korigjuara	Njësi të korigjuara
1	Deçan	28	597
2	Dragash	25	1643
3	Ferizaj	29	2135
4	Fushë Kosovë	4	246
5	Gjakovë	24	2199
6	Gjilan	35	1959
7	Glllogoc	30	1390
8	Graçanica	3	655
9	Hani i Elezit	2	158
10	Istog	6	828
11	Junik	2	79
12	Kaçanik	8	834
13	Kamenicë	9	1819
14	Klinë	24	1014
15	Klllokot	1	45
16	Leposaviq	25	573
17	Lipjan	36	1142
18	Malishevë	2	1747
19	Mamushë	1	45
20	Mitrovicë Jugore	24	1217
21	Mitrovicë Veriore	3	478
22	Novobërdë	11	489
23	Obiliq	10	680
24	Partesh	5	144
25	Pejë	53	2358
26	Podujevë	5	2770
27	Prishtinë	26	5201
28	Prizren	41	711
29	Rahovec	9	1819
30	Ranillug	3	130
31	Shtërpcë	5	245
32	Shtime	8	577
33	Skenderaj	26	781
34	Suharekë	30	848
35	Viti	28	786
36	Vushtrri	30	1795
37	Zubin Potok	183	19
38	Zveçan	13	88
TOTALI		807	40244

4.2 REGJISTRIMI, MODIFIKIMI DHE FSHIRJA E HIPOTEKAVE NË FORMË DIGJITALE

Pjesë e avancimit të shërbimeve digjitale të cilat AKK ka implementuar gjatë këtij viti ka qenë edhe regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e hipotekave në formë digjitale.

Komunikimi për këtë formë të regjistrimit realizohet në kohë reale, mes sistemeve bankare dhe Sistemit të Informatave Kadastrale për Tokën në Kosovë – SIKTK duke ngritur kështu në nivel të lartë saktësinë e të dhënave dhe ulur maksimalisht mundësisë eventuale të gabimeve gjatë regjistrimit të hipotekave pastaj duke eliminuar burokracinë përmes ofrimit të shërbimit të shpejtë dhe të sigurtë si dhe duke kursyer në masë të madhe koston kohore të gjithë akterëve të përfshirë në procesin e hipotekimi duke përfshirë këtu qytetarët, zyrtarët e institucioneve kredituese dhe zyrtarët e zyrave kadastrale komunale.

Zyrtarët e bankave, institucioneve mikrofinanciare, kompanive të sigurimeve e as qytetarët me ofrimin e këtij shërbimi nuk do kenë nevojë të shkojnë fizikisht në zyre kadastrale komunale për të marr shërbime të tilla që lidhen me hipoteka, me çka kursehet kohë në regjistrim të hipotekës, dokumentet përcillen në formë elektronike, rritet kualiteti i të dhënave që regjistrohen, etj, pasi që të dhënat e hipotekave plotësohen në formë automatike duke shfrytëzuar ueb shërbimet e zhvilluara nga AKK-ja për këtë qëllim.

Ajo që është shumë e rëndësishme të potencohet në këtë zhvillim është që nuk do ketë hapsirë për keqpërdorime eventuale (prona e njëjtë nuk do ketë mundësi të vendoset në hipotekë në kohë të njëjtë me prioritet të njëjtë në dy banka të ndryshme), si dhe nuk do ketë mundësi të prioritizohen radhët e regjistrimit të hipotekave. Pra hipoteka që është dorëzuar dje, duhet regjistruar para asaj që dorëzohet sot. Para fillimit të aplikimit të këtij zhvillimi AKK-ja ka nënshkruar Memorandume bashkëpunimi me të gjitha bankat e Institucionet mikrofinanciare. Memorandume bashkëpunimi mes AKK-së dhe 10 bankave:

- ProCredit Banka,
- Raiffeisen Bank,
- Banka Kombëtare Tregtare,
- TEB Banka,

- NLB Banka,
- IsBanka,
- Ziraat Banka,
- Banka Ekonomike,
- Banka për Biznes,
- Banka Credins.

Memorandume bashkëpunimi me 6 Institucione mikrofinanciare:

- Institucionit Mikrofinanciar Finca Kosovë,
- KEP Trust Kosovo Enterprise Program,
- Institucionit Financiar Jo Bankar LESNA,
- Agjencioni për Financim në Kosovë,
- Kreditimi Rural i Kosovës,
- BiCredit.

Ky zhvillim ka ardhur në një kohë sfiduese për të gjithë, në përballje me pandeminë e shkaktuar nga Covid 19, kur shumë institucione kanë punuar me orar të shkurtuar dhe me staf të reduktuar, e për qytetarët ka qenë problematike të marrin shërbimet në kohë optimale. I gjithë procesi ka kaluar në disa faza. Fillimisht zhvillimi i ueb shërbimit nga ana e AKK-së më pastaj faza e zhvillimit dhe avancimit të sistemeve individuale të të gjitha institucioneve mikrofinanciare, faza e trainimit të përdorimit të sistemit të ri për regjistrim, modifikim dhe fshirje të hipotekës, fazës testuese dhe në fund fillimit të aplikimit të sistemit të ri.

Përveç zyrtarëve të institucioneve financiare, për implementimin me sukses të sistemit të ri për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e hipotekave, AKK-ja ka ftuar në trajnim zyrtarët e të gjitha zyreve kadastrale komunale për ti informuar dhe udhëzuar ata me formën e re të regjistrimit të hipotekave. Sigurisht që për ZKK-të janë minimalizuar në maksimum aktivitetet në lidhje me regjistrimin e hipotekave megjithatë janë sqaruar detajet e reja dhe rrjedha e punës që duhet ndjekur ZKK-ja në këtë proces.

Pas përfundimit të trajnimit për zyrtarët e ZKK-ve, këta të fundit janë shprehur

shumë të kënaqur me formën e re e cila i ka liruar ata nga disa obligime që kanë patur me sistemin paraprak dhe iu është lehtësuar në masë të madh i gjithë ky proces. Për shkak kufizimeve të pandemisë nga secila ZKK janë ftuar që në trajnim të marrin pjesë vetëm nga një zyrtarë, që mandej të njëjtit ti përcjellin njohuritë tek kolegët e tyre. Me këtë zhvillim të digjitalizimit të gjithë procesit të hipotekave dhe të tjera të ngjashme AKK-ja planifikon që të rris edhe më tepër kualitetin e të dhënave, të ofrojë shërbime më të shpejta, më të mira si dhe të ofroj qasje më të lehtë në të dhëna kadastrale dhe pronësore juridike.



Takim dhe trajnim virtual me bankat komerciale

5. MONITORIMI I PUNËVE DHE AKTIVITETEVE TË ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE GJEODETE DHE GJEODETËVE TË LICENCUAR

Bazuar në dispozitën e nenit 4, paragrafit 10 të Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër, AKK është përgjegjëse për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve kadastrale, aktivitetet këto të cilat ligjërisht janë të deleguara në ZKK, kompanitë gjeodete dhe gjeodetët e licencuar. Me qëllim të realizimit të kësaj përgjegjësie AKK ka formuar grupin punues për monitorimin e punëve dhe aktiviteteve kadastrale, i cili është përgjegjës për realizimin e kontrollit të lëndëve e të cilat janë të regjistruara në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK).

Monitorimi i këtij viti ka qenë i shtati (7) me radhë dhe i njëjti është ndarë në tri pjesë, duke përfshi pjesën grafike, atë pronësore-juridike dhe pjesën tekstuale. Me qëllim të ngritjes së cilësisë së të dhënave në kadastër dhe me qëllim të avancimit në ofrimin e shërbimeve kadastrale në nivel vendi, AKK, gjatë vitit 2019 ka nxjerrë njëmbëdhjetë (11) udhëzime administrative, gjashtë (6) prej të cilave në fushën e kadastrit, ndikimi pozitiv i të cilave ka qenë i drejtpërdrejtë për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

Pas hyrjes në fuqi të Udhëzimeve të reja administrative, AKK-ja ka monitoruar nëse ZKK-të kanë filluar zbatimin e tyre, e që ky monitorim ka përfshirë lëndët e muajve Janar-Mars 2020. Gjatë muajve Prill dhe Maj 2020, grupi punues i përbërë nga ekspertë të AKK-së, duke punuar online nga distanca për shkak të pandemisë, kanë kontrolluar/monitoruar lëndët e të gjitha zyrave kadastrale komunale të Republikës së Kosovës, të cilat lëndë kanë qenë të ngarkuara në SIKTK duke bërë edhe kontroll kualiteti të lëndës së dorëzuar dhe ngarkuar edhe të regjistrimit të së njëjtës në sistem.

Pas kontrollimit të lëndëve për secilën ZKK është përpiluar raporti voluminoz i monitorimit me mbi 500 faqe i cili gjatë muajit Korrik 2020 i është përcjellë, ZKK-ve dhe Kryetarëve të komunave dhe gjeodetëve e kompanive gjeodete të licencuara me kërkesë për eliminimin e parregullsive të evidentuara. Numri dhe llojet e lëndëve të kontrolluara për çdo komunë është paraqitur në tabelën më poshtë:

Komuna	Nr.i lëndëve të kontrolluara bazuar në llojin e tyre						
	Bartje të pronësisë	Qira- mbajtje	Hipoteka	Ndarje	Bashkim	Ndërtesa dhe pjesë të ndërteave	Total
Lipjan	4	0	2	3	3	4	16
Shtime	4	1	2	6	2	1	16
Viti	4	0	1	4	3	1	13
Kllokot	3	0	1	3	3	0	10
Klinë	4	0	2	7	5	0	18
Istog	4	1	1	5	4	2	17
Junik	4	1	1	2	1	0	9
Deçan	4	1	2	1	3	1	12
Kamenicë	4	0	1	3	0	2	10
Novobërdë	4	0	1	5	3	2	15
Gjilan	5	1	2	7	3	3	21
Dragash	4	0	0	5	1	1	11
Ferizaj	3	1	1	2	1	1	9
Fushë Kosovë	4	0	1	7	4	2	18
Gjakovë	5	0	2	3	2	2	14
Gllgoc	8	0	1	5	2	1	17
Graçanicë	6	1	0	5	4	0	16
Hani i Elezit	7	0	0	2		1	10
Kaçanik	5	0	0	4	4	2	15
Obiliq	5	0	1	4	2	1	13
Partesh	9	0	0	3	2	0	14
Pejë	4	0	1	8	8	2	23
Podujevë	7	0	2	3	2	3	17
Mamushë	4	0		1	1	0	6
Mitrovicë	4		1	4	4	2	15
Mitrovicë e Veriut	4	0	0	0	0	1	5
Vushtrri	5	0	1	4	3	1	14
Suharekë	7	0		2	1	2	12
Skenderaj	4	0		2	1	1	8
Rahovec	4		1	5	4	2	16
Malishevë	3	0	1	4	3	0	11
Prizren	4	1	1	10	9	2	27
Ranillug	10	0	0	2	0	1	13
Prishtinë	4	1	1	17	10	2	35
Shtërpçë	5	0	0	0	3	0	8
Total	504 lëndë						

Gjatë vitit 2020 AKK ka nxjerrë edhe disa botime ligjore e profesionale përkatësisht Kornizën e re të Punës me anë të së cilës janë rregulluar dhe standardizuar të gjitha çështjet që ndërlidhen me fushën e kadastrit dhe regjistrimit të të drejtave pronësore. Andaj duke u bazuar nga kjo monitorimi i radhës do të përfshijë periudhën pas hyrjes në fuqi të Kornizës së re të Punës Nr. AKK 2020/01, dhe njëherit do të ndërmerren edhe masa konkrete konform kornizës ligjore për të gjithë ata që nuk zhvillojnë punët dhe aktivitetet kadastrale konform standardeve kadastrale.



Monitorimi i Kompanive të Licencuara Gjeodete

6. LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE

Një prej obligimeve dhe përgjegjësi ligjore të Agjencisë Kadastrale e Kosovës bazuar në Ligjin Nr. 04/-L-013 për Kadastër është edhe licencimi i gjeodetëve dhe kompanive gjeodete. Në kuadër të kësaj një prej 11 Udhëzimeve Administrative që u ndryshuan gjatë fund vitit 2019 ishte edhe Udhëzimi Administrativ për Licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete.

Ndryshimi i këtyre Udhëzimeve Administrative ndikoi edhe në ndryshimin apo ridelegimin e kompetencave për punë kadastrale dhe gjeodezike, përfshi ndalimin e matjeve në terren për zyrtarët e Zyrave Kadastrale Komunale dhe bartjen e kësaj kompetence te gjeodetët dhe kompanitë gjeodete të licencuara. Me bartjen e kësaj kompetence, AKK krijoi edhe mekanizma për ngritje profesionale të gjeodetëve kandidat për licencim, duke shtuar një kriter shtesë për certifikimin e njohurive ligjore dhe teknike përmes procesit të testimit, i cili testim u bë përmes aplikacioneve të veçanta të testimit, me çka u siguria transparencë maksimale e gjithë këtij procesi.

Gjithsesi para këtij testimit, AKK kishte ofruar materiale të mjetftueshme dhe mbajtur trainime për kandidatët për licencim me temat si matjet kadastrale e gjeodezike në terren, pjesa grafike dhe tekstuale e Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë, KOPOS-i etj. Përveç ndryshimeve të kriterit për licencim u ndryshuan edhe afatet kohore për aplikim, duke dhënë kështu mundësi AKK-së për organizim sa më të mirë të procesit të licencimit. Periudhat e hapura për aplikim për licencim gjatë vitit ishin katër: 01-15 Janar, 01-15 Mars, 01-15 Qershor dhe 01-15 Shtator 2020.

Po ashtu ndryshime pati edhe në kategori të licencave ku këtë vit përveç kategorisë së gjeodetëve dhe kompanive gjeodete u shpërndan licenca edhe për kategorinë e teknikëve gjeodetë. Gjatë vitit 2020 në Republikën e Kosovës janë licencuar për veprimtari profesionale gjithsejtë 35 gjeodetë, 25 teknik gjeodet, dhe 7 kompani gjeodete. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2020, Komisioni për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve, duke zbatuar Udhëzimin Administrativ Nr. 13/19 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve, përkatësisht dispozitën nga neni 29, ku përcaktohet se “Gjeodetët e licencuar, kompanitë gjeodete dhe personat fizik të vaçantë të licencuar të cilët kanë licencë të vlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ në afatin prej një (1) viti duhet t’i plotësojnë kushtet e parapara në dispozitën e nenit 6, 8, dhe 11 të këtij Udhëzimi Administrativ, duke përjashtuar dispozitën e nenit 6 paragrafi 1.6 të këtij Udhëzimi

Administrativ”, pasi që i ka njoftuar fillimisht të gjithë gjeodetët e licencuar dhe kompanitë gjeodete të licencuara, për obligimet që rrjedhin nga kjo dispozitë, ka pranuar dokumentacionin plotësues dhe të njëjtin e ka shqyrtuar. Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues sipas nenit 29 të Udhëzimit Administrativ Nr. 13/19 që nga dt. 01.12.2020 është filluar monitorimi në terren i zyrave të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara, ku deri në fund të vitit nga ky monitorim, Komisioni për Licencim ka konstatuar dhe ka marrë vendim që 15 personave fizik dhe tri kompanive gjeodete ju bëhet pushimi i veprimtarisë sipas licencave të tyre, përkatësisht ndalimi i kryerjes së punëve kadastrale dhe gjeodezike.

Menaxhimi i aplikacioni per testim online te gjeodeteve privat

Menaxhmenti i AKK ka kërkuar një aplikacion për testimin online të gjeodetëve privat të Kosovës. Është bërë hulumtim në internet dhe pas analizave dhe testimeve është propozuar dhe prezantuar para inicuesve të kërkesës web aplikacionin speedexam, i cili është miratuar. Speedexam është përdorur në versionin e mbajtjes së testit deri në 50 kandidat në muaj pa pagese. Stafi i TI-së gjatë këtij viti ka ndihmuar dhe në mbarëvajtjen e testit për licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodezike private. Organizimi i testit online gjatë këtij viti është bërë në 3 raste (shkurt, gusht dhe tetor) me gjithsejtë 94 kandidat. Në shkurt menaxhimi i testit është bërë për 54 kandidatë, në gusht për 23 dhe në tetor për 17. Testit në të tri rastet është mbajtur në sallën e madhe të trajnimeve në AKK.



7. SISTEMI I UNIFIKUAR I ADRESAVE

Njësia e Adresave në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në vazhden e aktiviteteve për kompletimin dhe mirëmbajtjes e Sistemit të Adresave, gjatë vitit 2020 ka realizuar këto aktivitete:

- **Mirëmbajtja e Regjistrit të Adresave**

Në kuadër të aktiviteteve për mirëmbajtjen e të dhënave të adresave, janë ndërmarre këto aktivitete:

- Përditësimi i Doracakut për Sistemin e Adresave në Kosovë;
- Mbështetje profesionale dhe teknike për drejtoritë e urbanizmit nëpër komuna;
- Kontrollimi të dhënave të adresave përmes ARIS-it, për komunat të cilat kanë aprovuar të dhënat ;
- Mbështetje për zyrat e urbanizmit me harta, manuale dhe materiale tjera të nevojshme;
- Shqyrtimi teknik i vendimeve për emërtimin e rrugëve të aprovuara nga kuvendet komunale;
- Trajnime rreth metodologjisë së adresimit;

Mbështetja profesionale dhe teknike ka rezultuar me ofrimin e rekomandimeve përkitazi me mirëmbajtjen e të dhënave të adresave, shtimi i rrugëve të reja, emërtimi dhe riemërtimi i rrugëve, shtimi i hyrjeve të adresave, kontrollimi i të dhënave të adresave sipas standardeve të përcaktuara etj.

Pas procesit të kontrollimit të të dhënave të adresave nga ana e zyrave të urbanizmit, është bërë edhe një kontrollë për metodologjinë e emërtimeve dhe numërtimeve. Mbështetja për zyrat e urbanizmit është bërë edhe me harta, manuale dhe materiale tjera të nevojshme për zyrat e urbanizmit, pastaj në kuadër të procedurave për emërtimin e rrugëve është bërë edhe shqyrtimi i teknik i vendimeve të kuvendeve komunale për emërtimin dhe ri emërtimin e rrugëve. Gjithashtu aktivitet me rëndësi ka qenë edhe organizimi i trajnimeve për zyrtarët e urbanizmit, në grupe dhe individuale rreth metodologjisë së adresimit në Kosovë.

Si aktivitet me rëndësi, i cili do të kontribuoj në përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe mirëmbajtjes së të dhënave të adresave në përgjithësi, është organizimi i punëtorisë dy ditor i Adresave me zyrat e urbanizmit, të mbështetur

nga Autoriteti Norvegjez për Hartografi. Në këtë punëtori është diskutuar rreth temave me rëndësi si: mirëmbajtja e të dhënave, procesi i emërimit të rrugëve, përmirësimi i legjislacionit, sinjalizimi i adresave etj., ku nga kjo punëtori janë nxjerrë konkluzione të rëndësishme, të cilat janë përmbledhur në një raport të veçantë.

- Funkcionimi i Sistemit të Informimit të Regjistrimit të Adresave ARIS

Aktivitetet e ndërmarra në kuadër të mirëmbajtjes së Sistemit të Informimit të Regjistrimit të Adresave:

- Zhvillimi i modulit për printimin e Certifikatës së Adresës përmes ARIS-it;
- Kontrollimi permanent (gjatë punës) i funksionaliteteve të ARIS-it;
- Përpilimi i raporteve të gabimeve eventuale të ARIS-it
- Dërgimi i raporteve tek kompania e cila mirëmban ARIS-in
- Komunikimi me kompaninë dhe ofrimi i sqarimeve rreth problemeve eventuale;
- Kontrollimi i gabimeve të përmirësuara nga kompania.
- Kontrollimi i problemeve/gabimeve eventuale në ARIS është bërë gjatë punës permanente me ARIS, më pastaj janë përpiluar raportet e gabimeve janë dërguar tek kompania dhe janë dhënë sqarime shtesë rreth gabimeve të caktuara dhe në fund është bërë kontrollimi i përmirësimeve të gabimeve nga kompania.

- Projekt propozimi për kompletimin e Sistemit të Adresave

Në mënyrë që të kompletohet Sistemi i Adresave në tërë territorin e Kosovës, Njësia e Adresave pranë AKK-së ka përgatitur projekt propozimin për kompletimin e Regjistrimit të Adresave, me të cilin parashihet azhurnimi i të dhënave të adresave, plotësimi i regjistrimit të adresave në komunat veriore, kompletimi me tabela të emrave të rrugëve dhe numra të adresave, ndërlidhja e adresave me bazat e të dhënave me institucioneve tjera etj. Ky projekt propozim është përgatitur për projektin e Bankës Botërore REGIP. Me realizimin e këtij projekti do përmbyllet adresimi në Republikën e Kosovës me të gjitha atributet e veta si:

- Vendosja e të gjitha tabelave me emërtimet e rrugëve duke përfshirë edhe rivendosjen e atyre të dëmtuarave
- Vendosjen e të gjitha tabelave me numrat e objekteve (shtëpive) në gjithë

territorin e Kosovës

- Krijimin e sistemit unik shtetëror (aplikacionit) të navigimit
- Ndërlidhjen e qytetarit (regjistrir civil) me adresën zyrtare
- **Bashkëfinancimi i prodhimit dhe instalimit të tabelave të numrave të adresave në 6 komuna**

Në vazhden e punëve për kompletimin dhe informimin e opinionit publik rreth adresave të reja, unike dhe zyrtare, Njësia e Adresave pran AKK-së ka vazhduar planifikimet për përgatitjen e projektit për bashkëfinancimin e prodhimit dhe instalimit të tabelave të numrave të adresave, me mbështetjen e Autoritetit Norvegjez për Hartografi, në 6 komuna të Kosovës, Ferizaj, Kamenicë, Viti, Obiliq, Klinë dhe Malishevë.

Si fazë fillestare e projektit është bërë nënshkrimi i Memorandumeve të Bashkëpunimit me 6 komunat në mënyrë që të ndahen përgjegjësitë e secilës palë AKK, SK dhe Komuna. Si pjesë e marrëveshjes është që Autoriteti Norvegjez për Hartografi do të ndaj për secilën komunë një fond të caktuar, kurse komunat do të financojnë pjesën e mbetur të projektit. Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dokumentet e nevojshme për projektin, si: specifikat teknike, statistikat e numrave për prodhim, përgatitja e materialeve, trajnimet për stafin komunal etj.

- **Shpërndarja e të dhënave të adresave për institucionet qeveritare**

Duke u bazuar në përgjegjësitë e AKK-së e cila është edhe shpërndarja e të dhënave të adresave, dhe me qëllim të informimit dhe shfrytëzimit sa më të madh të adresave të reja, unike dhe zyrtare, Njësia e Adresave pran AKK-së ka bërë shpërndarjen e të dhënave të adresave sipas Ligjit të Sistemit të Adresave për rreth 18 institucione publike, ndër të tjera edhe me institucione të rëndësishme siç janë:

- Agjencia e Statistikave të Kosovës ku në kuadër të përgatitjeve për regjistrimin e popullsisë 2021 rreth azhurnimit të qarqeve regjistruese është duke bërë edhe ndërlidhjen e ekonomive familjare me adresa,
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e cila është duke i ndarë zonat zgjedhore duke u bazuar në të dhënat e adresave zyrtare,
- Departamenti i Tatimit në Pronë është duke i lidhur tatim paguesit me adresat zyrtare etj.

Në vazhden e informimit dhe nxitjes së shfrytëzimit të të dhënave zyrtare të adresave, janë nënshkruar edhe memorandumet e bashkëpunimit me Postën e Kosovës dhe KEDS. Këto memorandume synojnë bashkëpunimin rreth lidhjes së adresave me sistemet e institucioneve përkatëse. Me postën gjithashtu synohet krijimi i zonave postare në formatin hartografik digjital, ku më pastaj do të futen në ARIS. Me këtë proces do të kompletohet edhe një element i rëndësishëm i adresave. Njësia e Adresave pranë AKK-së është duke punuar grupet punuese teknike për realizimin e detyrave dhe obligimeve.

- Përditësimi i të dhënave të adresave bazuar në ortofoto të vitit 2018

Si pjesë e aktivitetit të vazhdueshëm dhe duke u bazuar në mundësitë që janë krijuar me krijimin e ortofotove në vitin 2018, është bërë kontrollimi, aprovimi, rivlerësimi dhe përditësimi i të dhënave të adresave për rrugët dhe hyrjet e objekteve të adresave bazuar në ortofotot e vitit 2018 direkt në aplikacionin ARIS.

Më poshtë janë paraqitur statistikat e përditësimeve:

- 788 rruge janë kontrolluar prej tyre 653 janë aprovuar përmes ARIS-it,
- 38038 hyrje janë kontrolluar prej tyre 30802 janë aprovuar,
- 6275 hyrje janë përditësuar prej tyre 2045 hyrjeve u janë përditësuar pozicioni kurse 3150 hyrje janë rinumëruar,
- 521 hyrje janë fshirë për shkak të dyfishimit të pozicionit dhe numrave të hyrjeve,
- 559 hyrje janë shtuar duke u ndryshuar rruga në të cilën kanë qasje,
- 5102 segmente rrugore janë përditësuar sipas ortofotos 2018.

- Matjen e rrugëve të reja në teren

Aty ku ndryshimet e të dhënave të rrugëve kanë qenë më të mëdha dhe në pamundësi që ndryshimet të bëhen përmes aplikacionit direkt, është bërë matja e rrugëve të reja nëpër komuna të ndryshme, duke përfshirë edhe Auto udhën Arbën Xhaferi, me GPS dhe pastaj është bërë edhe post procesimi dhe bashkimi me shtresën aktuale të rrugëve në ARIS.

8. AVANCIMI I BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONE PUBLIKE

Agjencia Kadastrale e Kosovës, institucion ky kompetent për administrimin e regjistrave pronësorë, hartografisë, kadastrës, gjeodezisë, sistemit të unifikuar të adresave dhe infrastrukturës kombëtare për informacione gjeohapësinore këtë vit shënoi një avancim të bashkëpunimit me institucione publike të vendit. Ndër takimet më të rëndësishme mund të përmenden ato me Zv. Kryeministrin e Parë të Qeverisë së Republikës së Kosovës z. Besnik Tahirin. Takimi, pos aspektit ceremonial për shënimin e përvjetorit të 20-të të themelimit të AKK-së, u shfrytëzua nga z.Tahiri e z.Ahmeti për të biseduar rreth aktiviteteve të ndërsjella, të arriturve dhe sfidave me fokus kryesor identifikimin e mjeteve ligjore, profesionale e teknologjike për tejkalim të sfidave dhe avancim para. Në fjalën e tij të rastit z.Tahiri pos kishte uruar personelin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës për këtë përvjetor jubilar, ai kishte theksuar edhe peshën që ky institucion ka për shtetin e Kosovës duke thënë se i njëjti është një prej institucioneve të para publike të pas luftës.



Moment nga vizita e zv. Kryeministrit z. Besnik Tahirit në AKK

Po ashtu, ky rast ishte u shfrytëzuar edhe për lancimin dhe prezantimin e logos së re të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, e cila do të jetë shenjë dalluese e këtij institucioni në të ardhmen.



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Katastarska Agencija Kosova
Kosovo Cadastral Agency

8.1 MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE PUBLIKE

Si rezultat i bashkëpunimit institucional e profesional disa vjeçar mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Institucioneve Publike dhe autoriteteve të cilat ushtrojnë funksione publike në fushën e shkëmbimit të të dhënave, respektivisht ofrimit të informacioneve nga regjistrat pronësorë të cilat administrohen nga AKK janë mbajtur takime të cilat kanë rezultuar me nënshkrimin e memorandumëve për bashkëpunim me të cilët bazuar në legjislacionin në fuqi, ti sigurohet qasje në shikim, printim dhe shënim në certifikatat pronësore të administruara nga AKK.

Ky avancim i mënyrës së bashkëpunimit vjen si rezultat i disa avancimeve që kohëve të fundit ka zhvilluar AKK e që kanë rezultuar me kalimin prej mënyrës tradicionale të ofrimit të të dhënave (CD, email, letër) në mënyrë të avancuar, përmes ofrimit të qasjes në të dhëna në kohë reale dhe përmes ueb shërbimeve.

Kjo mënyrë e bashkëpunimit ndërinstitucional do të ngrit shkallën e sigurisë së transaksioneve pronësore, do të shmangeshin procedurat burokratike, do të ngritet shkalla e transparencës, do të mundësohej ofrimi i të dhënave kualitative e në kohë reale. Përndryshe, për aspektin teknik të implementimit të këtyre memorandumëve, AKK do të ofrojë edhe trajnime të nevojshme për zyrtarët e Institucioneve Publike dhe autoriteteve të cilat ushtrojnë funksione publike për operim me qasje të limituar në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.

AKK ka nënshkruar memorandum bashkëpunimit me:

- Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- Policinë e Kosovës;
- Njësinë për Inteligjenc Financiare;
- Odën e Përmbauesve Privat të Kosovës;
- Odën e Noterëve;
- Administratën Tatimore të Kosovës;
- Agjencinë Anti Korrupsion dhe Agjencinë e Statistikave;
- Agjencia Kosovare për Inteligjencë.



Moment nga nënshkrimi i marrëveshjes me Agjencinë Kundër Korrupsionit



Moment nga nënshkrimi i marrëveshjes me Odën e Noterëve




Moment nga nënshkrimi i marrëveshjes me AKI

9. KOORDINIMI I PROJEKTEVE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës ekziston edhe Njësia për Implementimin e Projekteve, e cila si pasuese e Zyrës për Koordinimin e Projekteve, siguron që të gjitha aktivitetet e projektit të jenë në përputhje me ligjet vendore dhe kërkesat, procedurat dhe rregullat e vetë donatorëve apo përkrahësve si Banka Botërore, JICA, SIDA, Autoriteti Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi Kartverket, Qeveria Holandeze. Sa i përket projekteve kryesore aktuale të cilat zhvillohen në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës me përkrahjen e organizmave ndërkombëtare janë:

- Projekti për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP),
- Projekti përkrahës i Qeverisë Norvegjeze,
- Projekti regional SPATIAL II i përkrahur nga Qeveria Holandeze si dhe
- Projekti për gjeneralizimin e hartave topografike me shkallë të vogël, përkrahur nga JICA Japoneze.



Harta topografike me shkallë të vogël

9.1 PROJEKTI PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME DHE INFRASTRUKTURËS GJEO-HAPËSINORE (REGIP)

Projekti për regjistrimin e Pronës së paluajtshme dhe infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP) është i mbështetur nga Banka Botërore në formë kredie në vlerë prej 14.600.000 Euro.

Projekti do të implementohet në periudhën 5 vjeçare dhe është bërë efektiv me 02 shtator 2020. Projekti përbëhet nga këto komponentë:

Komponenti A. Politikat, Mbështetja Ligjore dhe Institucionale: Qëllimi i Komponentit A është të ofrojë mbështetje politike, ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Kjo komponentë do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) zhvillimin e një strategjie të përditësuar të AKK-së dhe planit të biznesit për të informuar dhe udhëzuar zhvillimin e ardhshëm të të dhënave dhe shërbimeve kadastrale dhe gjeohapësinore në Kosovë; dhe (b) zhvillimin e mëtejshëm të Ligjit të ri të Kadastrit.

Komponenti B. Modernizimi i Kadastrit: Objektivi i këtij komponenti është vazhdimi i modernizimit të kadastrit në Kosovë, e cila filloi në kuadër të projektit paraprak për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër (RECAP). Ky komponent do të financojë sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) rindërtimin e informacioneve kadastrale në 140 Zona Kadastrale; (b) përmirësimi i cilësisë së të dhënave kadastrale; (c) zhvillimin e kadastrit të përçojave; (d) zhvillimin e regjistrit të ndërtesave; dhe (e) renovimin dhe ri-inzhinjerimin e Zyrave Kadastrale Komunale.

Komponenti C. Teknologjia e Informacionit dhe Infrastruktura Gjeohapësinore: Objektivi i këtij komponenti është të bëjë investime në sistemet

e IT-së dhe investime për të dhënat gjeohapësinore për tregun e tokës dhe pronës në Republikën e Kosovës dhe do të mbështesë zbatimin e strategjive të AKK-së për IT dhe Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH). Ky komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) përmirësimin e Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë në drejtim të Arkitekturës së Orientuar në Shërbime (SIKTK-AOSH); (b) Arkivin digjital të AKK-së; (c) Zbatimin e strategjisë së IT-së për AKK-në; (d) investimet në IKIH (ang.NSDI); dhe (e) Zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjetit shtetëror gjeodezik të GPS-it, KOPOS.

Komponenti D. Menaxhimi i Projektit, Ndërtimi i Kapaciteteve, Informimi Publik dhe Monitorimi dhe Vlerësimi : Qëllimi i këtij komponenti është të sigurojë zbatimin e plotë në afat kohor të Projektit. Ky Komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) njësinë e zbatimit të projektit (PIU) dhe koordinimin e donatorëve; (b) monitorimin dhe vlerësimin; (c) anketat e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet kadastrale, (d) Informimi i publikut dhe mekanizmi i dëshmipërblimit (GRM);

Projekti REGIP është bërë efektiv tek me 02.09.2020 dhe nuk ka mundur të realizojë shumë aktivitete. Gjendja e pandemisë Covid 19 gjithashtu ka ngadalësuar ritmin e progresit të aktiviteteve. Aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit REGIP për vitin 2020 janë si vijon:

Projekti është aprovuar nga Bordi i Bankës Botërore me 18 dhjetor 2018. Projekti është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 23 prill 2020 dhe është ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës me datë 23 korrik 2020. Projekti përfundimisht është bërë efektiv me datën 02.09.2020;

Është krijuar Njësia Implementuese e Projektit (NJIP), duke përfshirë Udhëheqësin e Njesisë dhe specialistët e prokurimit, financave, GIS-it dhe marrëdhënieve me publikun. Sipas marrëveshjes së projektit, me hartimin e Project Operation Manual dhe krijimin e NJIP janë përmbushur kushtet për efektivitetin e projektit;

Është bërë ndërrimi i Task Team Leader –it për projektin nga Banka Botërore ku është bërë bartja e njohurive dhe është vendosur kontakti profesional me Agjencinë Kadastrale të Kosovës ;

Është përfunduar rishikimi i hollësishëm i aktiviteteve të projektit me ndryshime dhe plotësime të aktiviteteve, me që kanë ndodhur zhvillime të mëdha në AKK prej kohës kur është dizajnuar projekti në vitin 2018;

Janë hartuar Termat e Referencës dhe Specifikat teknike për disa aktivitete të projektit që janë pjesë e planit të prokurimit sipas komponentëve që janë:

- Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale deri në 120 Zona Kadastrale;
- Kontrolli i kualitetit të kontraktorëve të angazhuar për implementimin e rindërtimit të informacioneve kadastrale;
- Përmirësimi i të dhënave në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë;

- Zëvendësimi dhe azhurnimi i pajisjeve GNSS, duke përfshirë softuerin, licencat dhe pajisjet;
- Monitorim edhe Vlerësim të projektit;
- Hulumtimi i kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet kadastrale;
- Zhvillimi i Web portalit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës;
- Plani i Veprimit për komunikim dhe Informim të publikut;
- Angazhimi i stafit profesional për: IKIH, IT, Kadastër, M&E dhe Ligjor etj.

Është përfunduar projekti për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Biznesit të AKK-së për periudhën 2021-2025;

Është përfunduar projekti për hartimin e dokumenteve teknike për punë në Kadastër, siç janë: Korniza për punë kadastrale, Doracaku për rindërtim të informacioneve kadastrale, Doracaku për kadastrin e ndërtesave dhe Doracaku për procedurat e regjistrimit të pronës në Kadastër;

Është bërë planifikimi buxhetor i aktiviteteve të projektit për 3 vitet e ardhshme, me theks të veçantë për vitin 2021;

Sfida kryesore e projektit është alokimi jo i mjaftueshëm i mjeteve buxhetore tek kategoria e mallërve dhe shërbimeve nga Ministria e Financave sipas kërkesave të projektit.



Nënshkrimi i marrëveshjes për REGIP, viti 2018

9.2 PROJEKTI PËRKRAHËS I QEVERISË NORVEGJEZE

Përmes Statens kartverk, Qeveria e Norvegjisë për shumë vite ka përkrahur Agjencinë Kadastrale të Kosovës për zhvillimin e kadastrit dhe Administrimit të Tokës në Republikën e Kosovës. Marrëveshja e Grantit aktual me Agjencinë Kadastrale të Kosovës është nënshkruar me 7 Janar 2018 dhe ka qenë e planifikuar të përfundojë me 30 Tetor 2020, por për shkak të shtyerjes së implementimit të disa aktiviteteve nga situata e pandemisë Covid 19, në shtator 2020 është nënshkruar aneks marrëveshja për shtyerjen e afatit të implementimit të projektit deri më 31 dhjetor 2021. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të përcjellë, kompletojë, zgjerojë dhe përmirësojë aktivitetet nga projektet e mëparshme të Statens kartverk me Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Aktivitetet kryesore të planifikuara për periudhën e mbetur të implementimit të projektit janë:

- Sistemi i Adresave-Vendosja e tabelave me numrat e hyrjeve të objekteve në 6 Komuna (Malishevë, Klinë, Ferizaj, Obiliq, Kamenicë dhe Viti);
- Plotësimi i bazës së dhënave grafike në SIKTK;
- Zgjerimi i regjistrit të pronës dhe regjistrit të adresave në tri komunat në Veri të vendit;
- Ngritja e kapaciteteve të AKK-së;
- Përkrahje në hartimin e specifikave teknike për rrjetin e nivelimit në Republikën e Kosovës.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit përkrahës të Qeverisë Norvegjeze për vitin 2020 janë si vijon:

- Janë hartuar specifikat teknike, janë nënshkruar Memorandumet e Mirëkuptimit për bashkëfinancim me Komunitet Malishevë, Klinë, Ferizaj, Obiliq, Kamenicë dhe Viti dhe është shpallur tenderi për vendosjen e tabelave me numrat e hyrjeve të objekteve në 6 Komunitet e sipërpërmendura;
- Janë finalizuar Termat e Referencës për migrimin dhe konvertimin e të dhënave grafike në hartën kadastrale për Komunitetin e Prishtinës;
- Për përkrahje profesionale të AKK-së, janë angazhuar dy ekspertë për kadastrë për periudhën nëntor 2020 –dhjetor 2021;

- Është përkrahur zhvillimi i një video filmi të shkurtër për të shënuar arritjet e AKK-së me rastin e shënimit të 20 vjetorit të themelimit të AKK-së;
- Është përkrahur vizita e delegacionit të AKK-së në ASIG, ku janë nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi në fushat e interesit të përbashkët dhe për shkëmbimin e të dhënave GNSS midis KOPOS dhe ALBCORS.



Ilustrim, adresat

9.3 PROJEKTI SPATIAL II I PËRKRAHUR NGA QEVERIA HOLANDEZE

Projekti për ngritjen e qasjes profesionale në informacione për Tokën (SPATIAL II) në rajonin e Ballkanit Perëndimor është pjesë e programit të para-anëtarësimit MATRA. MATRA është një program i madh i drejtuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës, që synon ofrimin e mbështetjes për vendet e rajonit të Evropës Juglindore me perspektivat e pranimit në BE.

Objektivi i përgjithshëm i MATRA është avancimi i një demokracie pluraliste, bazuar në shtetin e së drejtës, inkurajimi i dialogut midis qeverisë dhe shoqërisë civile, ndërtimi i kapaciteteve dhe forcimi i institucioneve të shoqërisë civile dhe qeverisë, si dhe forcimi i marrëdhënieve dypalëshe. Projekti SPATIAL II ka për qëllim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit profesional dhe qasjen në informacion në lidhje me tokën në Ballkanin Perëndimor, me qëllim që t'i sigurojë shoqërisë një informacion të besueshëm në lidhje me tokën për mirëqenien sociale dhe ekonomike.

Projekti implementohet në periudhën 2020-2022 me përkrahje profesionale nga ekspertët e Autoritetit Holandez për kadastër dhe hartografi Kadaster.

Aktivitetet e planifikuara të projektit janë:

- Punëtoritë (workshopet) profesionale në Ballkanin Perëndimor;
- Vizita studimore në Holandë;
- Konsulencë profesionale nga ekspertët e Kadastër;
- Menaxhimi i projektit.

Gjatë vitit 2020 në kuadër të projektit SPATIAL II, janë paraparë të kryehen disa aktivitete, por për shkak të situatës me pandeminë Covid 19, disa aktivitete janë shtyrë apo edhe kryer online. Aktivitetet e realizuara gjatë këtij viti janë:

- Është mbajtur punëtorja (workshopi) për fillimin e projektit në Shkup, Maqedoni e Veriut me 07 shkurt 2020. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte të zhvillojë një plan veprimi për secilin Autoritet për Kadastër dhe Hartografi nga shtetet e Ballkanit Perëndimor për SPATIAL II, dhe për të rritur ndërgjegjësimin për IGIF dhe filluar operacionalizimin e IGIF;
- Është mbajtur punëtorja regjionale online me temën e Komacsonit të Tokave, ku është bërë shkëmbimi i përvojave profesionale midis Holandës dhe shteteve

të Ballkanit Perëndimor;

- Është ndihmuar AKK në finalizimin e Specifikave Teknike për Korrektimin e të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral për Tokën në Kosovë.

Janë mbajtur takime bilaterale për të diskutuar për caktimin e mbështetjes për Agjencinë kadastrale të Kosovës për temat e dakorduara:

- Zhvillimi institucional, promovimi i një modeli qeverisjeje që forcon mandatet institucionale dhe ndërton një mjedis bashkëpunues për shpërndarjen e të dhënave;
- Përmirësimi i cilësisë së të dhënave: mundësimi i AKK-së për të përmbushur menaxhimin e të dhënave, ndarjen dhe përdorimin e detyrimeve ndaj qeverisë dhe komunitetit të përdoruesve;
- IKIH dhe shërbimet elektronike: përcaktimi i zinxhirëve të furnizimit të të dhënave dhe shpërndarja dhe integrimi i të dhënave.



Takim virtual në kuadër të projektit SPATIAL II

9.4 PROJEKTI PËRKRAHËS I QEVERISË JAPONEZE

Në vazhden e përkrahjes së Qeverisë Japoneze nëpërmjet Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) për Agjencinë Kadastrale të Kosovës është duke u implementuar projekti “Zhvillimi i kapaciteteve për gjeneralizimin hartografik të hartave topografike digjitale në Kosovë”. Ky projekt ka për qëllim krijimin e kapaciteteve për krijimin e hartave topografike me shkallë të vogël 1:50,000, 1:100,000, 1:250,000 dhe 1:500,000, me çka zyrtarët e AKK-së do të rrisin kapacitetet e veta që në mënyrë të pavarur ta bëj përgjithësimin e Hartës Digjitale në shkallë të ndryshme.. Përgjithësimi hartografik, përfshin të gjitha ndryshimet gjatë procesit nga një hartë në shkallë më të vogël në harta më shkallë më të madhe si: nga shkalla e hartës topografike digjitale 1:25 000 në shkallë 1:50000, 1:100000 dhe 1:250000. Në këtë proces është duke u bërë konvertimi i të dhënave gjeohapësinore nga një nivel me i lartë i saktësisë tek një nivel më të ulët, krejt me qëllim që në fletën e hartës të përfshihet detaji me hapësirë më të madhe e cila thekson elementet më të rëndësishëm të hartës, gjithnjë duke punuar sipas rregullores për harta topografike.

Projekti ka qenë i paraparë të përfundojë gjatë vitit 2020, por për shkak të situatës me pandeminë Covid 19, është shtyer afati i implementimit të projektit deri më 31 Dhjetor 2021.

Gjatë vitit 2020 në kuadër të projektit “Zhvillimi i kapaciteteve për gjeneralizimin hartografik të hartave topografike digjitale në Kosovë”, janë paraparë të kryehen disa aktivitete, por për shkak të situatës me pandeminë Covid 19, disa aktivitete janë shtyrë (kryesisht trajnime) apo edhe planifikuar të mbahen online. Aktivitetet e realizuara gjatë këtij viti janë:

- Janë përgatitur të dhënat ArcGIS nga baza e të dhënave të hartës topografik 1:25,000;
- Janë krijuar indeks fletët e përfshirjes së hartave topografike me shkallë të ndryshme (1:50,000, 1:100,000, 1:250,000 dhe 1:500,000), dhe janë mbajtur trajnimet e nevojshme për këtë aktivitet;
- Është vazhduar afati i implementimit të projektit deri më 31.12.2021;
- Janë duke u zhvilluar trajnime online për ngritjen e kapaciteteve brenda AKK-së për krijimin e hartave topografike me shkallë të vogël.

Vlen të ceket se deri më tani është punuar në shkrirjen e të gjitha gjeodatabazave nga Harta Topografike 1: 25 000 e cila në vete përfshinë 155 gjeodatabaza, në një gjeodatabazë të vetme. Po ashtu është duke u punuar në specifikat e hartës topografike 1:250 000. (përmasat, simbolet dhe emërtimet), në shumicën e rasteve si model kemi marr hartën 1: 200 000 të Japonisë si dhe hartat që prodhohen në rajon, që e njëjta rregulla të veçanta që të njëjtat të zbatohen edhe në Kosovë.



Takim pune me përfaqësues të JICA-s

9.5 INICIATIVAT E AKK-SË PËR ZGJERIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR DHE REGJIONAL

TAKIM ME KREUN E BE-SË NË KOSOVË

AKK me rastin e shënimit të 20 vjetorit të themelimit të saj ka organizuar disa manifestime modeste, në mesin e të cilëve edhe vlerësimin me mirënjohje për kontributin dhe përkrahjen që disa institucione ndërkombëtare i kanë dhënë rrugëtimit 20 vjeçar të AKK-së. Në mesin e këtyre institucioneve vend të rëndësishëm zë edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë e për këtë arsye, me datë 11 dhjetor AKK-në e kishte vizituar kreu i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë z. Tomáš Szunyog, i cili u prit nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti. Boshti i atij takimi ishte rreth projekteve që në të kaluarën këto dy institucione kishin implementuar së bashku, respektivisht implementimi fillestar i sistemit të unifikuar të adresave, e që më pas kishte pasur edhe me një informim të shkurtër nga z. Ahmeti rreth gjendjes aktuale të adresave, avancimit të kornizës ligjore që rregullon fushën e adresave, avancimi i doracakut për sistemin e adresave, përdorimi obligativ i adresave zyrtare nga institucione të ndryshme publike, përdorimi i adresave nga kompani globale të navigimit e ngjashëm. Nga ana e tij z. Szunyog në takim kishte vlerësuar rolin e adresave në avancimin e qarkullimit të lehtë të njerëzve, në ofrimin e shërbimeve të ndryshme si dhe potencoi që adresat janë përkrahje e madhe edhe për implementim të projekteve të ndërlidhura kapitale, si që është regjistrimi i popullsisë. Në fund të takimit z. Ahmeti ia dhuroi edhe një mirënjohje si shenjë falënderimi për përkrahjen që Zyra e BE-së i ka dhënë AKK-së ndër vite. Si rezultat i këtij takimi, ekspertët e AKK-së i ishin drejtuar me shkresë për përkrahje Zyrës së BE-së në Kosovë, ndërsa përkrahje eventuale do të pasonte menjëherë gjatë vitit 2021.



Takim me kreun e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë z. Tomáš Szunyog

TAKIM ME KREUN E OSBE-SË NË KOSOVË

Thuaja se me të njejtën arsye, Agjencinë Kadastrale të Kosovës e ka vizituar edhe kreu i OSBE-së në Republikën e Kosovës, Ambasadori Jan Braathu. Qëllimi i këtij takimi ishte identifikimi i fushave të interesit të përbashkët ku këto dy institucione do të mund të bashkëpunonin në të ardhmen, e me fokus kryesorë rreth implementimit të strategjisë për të drejta pronësore, legalizimit të objekteve pa leje, fuqizimit të të drejtave pronësore të grave dhe procesin e ankimimit në AKK.

Në fillim të takimit, z. Ahmeti kishte informuar Ambasadorin Braathu mbi aktivitetet kapitale të AKK-së, mbi sfidat me të cilat është duke u ballafaquar si dhe me mënyrat më të përshtatshme se si mundet të tejkalohen këto sfida, respektivisht mbi avancimin e kornizës ligjore. Konkretisht, z. Ahmeti kërkoi përkrahjen e OSBE-së për shtyrjen para të dy draft ligjeve, atë për kadastër dhe atë për infrastrukturë kombëtare për informacioneve hapësinore. Z. Braathu nga ana e tij u pajtua që të ofrojë përkrahjen e tij në trajtimin e këtyre ligjeve. Sa i përket aspektit të përfshirjes së qytetarëve në përgjithësi e grave në veçanti në shfrytëzim të të drejtave pronësore, prijësit e institucioneve u pajtuan që të koordinohen në ndërmarrjen e fushatave për ngritje të vetëdijes mbi përfitimet nga një pronë e regjistruar në katastër.

Z. Braathu nga ana e tij ofroi përkrahjen për implementim të politikave gjuhësore në produktet dhe shërbimet që i ofron Agjencia, pasi që kjo është një sfidë për Agjencinë, e që vjen si pasojë e mungesës së kapaciteteve njerëzore.



Takim me kreun e OSBE-së në Kosovë, z. Ambasadori Jan Braathu

TAKIM ME USAID

Po ashtu, gjatë viti një takim i rëndësishëm ishte mbajtur me datë 9 korrik 2020 mes ekipeve gjithëpërfshirëse të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe USAID. Në këtë takim Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti kishte prezantuar fushat e përgjegjësisë së AKK-së respektivisht administrimin e regjistrave pronësorë, kadastrën, gjeodezinë, hartografinë, gjeoinformacionin dhe sistemin e unfikuar të adresave si dhe të arriturat e AKK-së në realizim të projekteve kapitale, reformat në kadastër, dokumentet profesionale, gjithëpërfshirjen në shfrytëzim të të drejtave pronësore e ngjashëm.

Një pjesë e takimit i ishte kushtuar edhe vlerësimit të bashkëpunimit të AKK-së me projektin për të drejta pronësore të USAID i cili kishte kulmuar me përpilimin e strategjisë për të drejta pronësore, me funksionalizimin e e-Kioskave në disa komuna dhe me përfshirjen e grave në shfrytëzim të të drejtave pronësore.

Për të fuqizuar se bashkëpunimi kishte qenë produktiv, z. Ahmeti potencoi se të gjeturat nga Strategjia për të Drejta Pronësore janë përfshirë edhe në reformat ligjore të ndërmarra nga AKK, respektivisht në 11 Udhëzimet e reja administrative nga fusha e pronës e adresave.

USAID, premtoi përkrahje për avancimin e legjislacionit, ndërsa po ashtu palët në takim u pajtuan që korrespondenca mes tyre të vazhdojë më tutje, krejt me qëllim që të shmanget duplikimi eventual i projekteve si dhe mundësisht të përfshihen interesat të AKK-së gjatë dizajnit të projektit vijues për të drejta pronësore të USAID-it.



Takim virtual me USAID

TAKIM ME SIDA

Për takimet e rëndësisë së madhe me organizata ndërkombëtare të realizuara gjatë vitit 2020 vend të rëndësishëm zë edhe ai me përfaqësues të SIDA-s, të mbajtur me 14 dhjetor, respektivisht me z-njën Nasrin Pourghazian, Zëvdënës Kryesuese e Misionit të SIDA-s në Kosovës dhe Kryesuese e Korporatës për Zhvillim e shoqëruar nga Menaxheri i Projekteve në SIDA, z. Fatos Mulla.

Boshti i këtij takimi ishte vlerësimi i projekteve që në të kaluarën këto dy institucione kanë implementuar së bashku, e që pasoi edhe me një informim të shkurtër nga z. Ahmeti rreth gjendjes aktuale të projekteve, avancimi i kornizës ligjore, gjithëpërfshirja shoqërore në aktivitetet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës e ngjashëm. Nga ana e saj z-nja Pourghazian vlerësoi kishte vlerësuar rolin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës në shoqëri e ishte zotuar për bashkëpunim në të ardhme.



Takim me SIDA-n



Kryeshefi Ekzekutiv i dhuron mirënjohje SIDA-s

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS NËNSHKRUAN DY MARRËVESHJE ME HOMOLOGËT NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në fushat e interesit të përbashkët, sot në ambientet e Autoritetit Shtetëror për Informacione Gjeohapësinore të Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2020 është mbajtur një takim pune mes Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti dhe Drejtorit të Autoritetit Shtetëror për Informacione Gjeohapësinore të Republikës së Shqipërisë z. Lorenc Çala. Po ashtu, pjesë e delegacionit të AKK-së, e me qëllim të informimit nga afër me përvojat dhe sfidat e institucioneve përgjegjëse për infrastrukturë gjeohapësinore dhe me qëllim të ofrimit të përkrahjes politike për nismat nga të cilat përfitojnë institucionet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës ishte edhe Zëvendës Ministria e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit z-nja Burbuqe Deva Bakija.

Në takim prijësit e institucioneve të sipër përmendura, kanë nënshkruar edhe dy marrëveshje, respektivisht një Marrëveshje Bashkëpunimi dhe një Marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave nga rrjetet permanente gjeodezike KOPOS dhe ALBCORS, respektivisht shfrytëzimi e pikave të rrjetit permanent të Republikës së Kosovës (KOPOS) nga Republika e Shqipërisë dhe shfrytëzimi i pikave të rrjetit permanent të Republikës së Shqipërisë (ALBCORS), nga Republika e Kosovës, që do të mundësonte mbulueshmërinë me sinjal për aktivitete gjeodezike që kryhen në zonat e brezit kufitar mes dyja shteteve. Ndërsa sa i përket Marrëveshjes për bashkëpunim, e njëjta specifikon fushat ku do të mund të thellohej bashkëpunimi mes institucioneve, si shkëmbimi i përvojave e ekspertizave, ofrimi i përkrahjes në fusha profesionale, harmonizimi i të dhënave gjeohapësinore e ngjashëm.



Nënshkrimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacione Gjeohapësinore të Republikës së Shqipërisë

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS NËNSHKRUAN DY MARRËVESHJE ME HOMOLOGËT MAQEDONAS

Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në fushat e interesit të përbashkët, ekspertët nga Agjencia Kadastrale e Kosovës kanë mbajtur takim pune me ekspertët e Agjencisë për Kadastër të Republikës së Maqedonisë.

Të njëjtit kanë nënshkruar edhe dy marrëveshje, respektivisht një Marrëveshje Bashkëpunimi dhe një Marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave nga rrjetet permanente gjeodezike KOPOS dhe MAKPOS, respektivisht shfrytëzimi e pikave të rrjetit permanent të Republikës së Kosovës (KOPOS) nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe shfrytëzimi i pikave të rrjetit permanent të Republikës së Maqedonisë së Veriut (MAKPOS), nga Republika e Kosovës, që do të mundësonte mbulueshmërinë me sinjal për aktivitete gjeodezike që kryhen në zonat e brezit kufitar mes dyja shteteve.

Ndërsa sa i përket Marrëveshjes për bashkëpunim, e njëjta specifikon fushat ku do të mund të thellohej bashkëpunimi mes institucioneve, si shkëmbimi i përvojave e ekspertizave, ofrimi i përkrahjes në fusha profesionale, harmonizimi i të dhënave gjeohapësinore e ngjashëm.

Menjëherë pas nënshkrimit të këtyre dy Marrëveshjeve, ekspertët e Agjencisë Kadastrale e Kosovës mbajtën edhe prezantim të dy projekteve të cilat ajo ka implementuar me sukses ndërsa në shtetin fqinj pritet të implementohen në të ardhmen, si Sistemi i Unifikuar i Adresave dhe përdorimi i fluturakes pa pilot (DRON) për matje kadastrale.



Nënshkrimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim me Agjencisë për Kadastër të Republikës së Maqedonisë së Veriut

10. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

10.1 ADMINISTRIMI I INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË DHE SISTEMEVE TË INFORMACIONIT (TI/SI)

Stafi i DTI-së menaxhon, administron dhe monitoron në baza ditore infrastrukturën në qendrën e të dhënave primare dhe qendrën sekondare (DRC), ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm profesional për të siguruar shërbime të pandërprera për të gjithë përdoruesit (users) e regjistruar në domenin kompjuterik (domain) të AKK si dhe për ata të internetit që shfrytëzojnë shërbime të hostuara në qendrën e saj të të dhënave.

Administron sigurinë e sistemit të TI në të gjitha nivelet dhe për të gjithë përdoruesit e regjistruar në domenin e AKK-së. Gjithashtu administron Sistemet e Informacioneve (SIKTK-SOA, SUUSHK, SIKTK-HK, SIRA, SI-RIK, KOPOS, Intranet, Sistemi i faturimit, Gjeoportali, etj.) në kuptimin e përgatitjeve të ambienteve për testime, trajnime dhe ambienteve reale, sipas kërkesave dhe nevojave. Pjesë e rëndësishme e administrimit të SI është edhe administrimi i databazave, qasjeve, zhvillimi i skripteve TSQL për nxjerrjen e raporteve, statistikave dhe për qëllime të hulumtimit ose të kontrollit të kualitetit të të dhënave kadastrale dhe të tjera, në nivel të databazave.

Stafi i TI-se gjatë vitit 2020 përveç detyrave rutinë të administrimit, menaxhimit dhe monitorimit të sistemit ka ndërmarrë edhe një sërë hapash për ngritjen e nivelit të sigurisë, automatizimin e proceseve dhe azhurnimin e platformës për menaxhimin e infrastrukturës virtuale. Aktivitetet tjera gjatë vitit 2020 janë si në vijim:

Implementimi i Microsoft LAPS (Local Administrator Password Solution)

Me qëllim të ngritjes së sigurisë në rrjet është bërë instalimi dhe konfigurimi i zgjidhjes “Microsoft LAPS” (Local Administrator Password Solution). Me këtë zgjidhje administratorit lokal të secilit kompjuter në ZKK, nga Active Directory i gjenerohet password unik i cili automatikisht ndryshohet çdo 120 ditë dhe ruhet në AD.

Krijimin dhe Implementimin e Scriptave në Geoportal për automatizimin e proceseve manuale

Problemet kryesore që janë shfaqur herë pas here në Gjeoportal: mosfunksionimi i butonit për printim, shfaqja e layerit “Pink”, mbushja e diskut me LOG-a si dhe ndonjëherë mos hapja e geoportalit në tërësi, janë zgjidhur duke bërë ristartimin e serviseve të caktuara në mënyrë manuale.

Ngritjen e versionit (Upgrade) të platformës për menaxhimin e infrastrukturës virtuale të TI-së

Prodhuesi VMware ka paralajmëruar që në dhjetor të këtij viti do të hiqet nga opsioni qasja në vSphere përmes Flash Player. Versioni i platformës, vCenter 6.5, në të cilën ishim duke funksionuar nuk ka qenë në gjendje që të funksionoj optimalisht me versionin e ri vSphere Client HTML5. Për të qenë në hap me azhurnimet e reja me qëllim të ruajtjes së funksionalitetit optimal dhe duke i shfrytëzuar licensat aktive kemi krijuar një strategji të azhurnimit të platformës VMware vCenter.

Procesi për azhurnimin e këtyre platformave ka qenë mjaft i ndërlikuar, mirëpo pas analizave të shumta paraprake dhe hartimit të strategjisë për këtë proces, duke përcjell “best practice” nga prodhuesi si dhe duke përdorur njohuritë e fituara pas trajnimit dhe certifikimit të stafit në VMware vCenter 6.7 - VCP 6.7 (2020), i gjithë procesi i azhurnimit ka përfunduar me sukses brenda 10 ditë pune (28.10-06.11.2020) duke mos shkaktuar as edhe një ndërprerje të sistemeve (0 downtime).

Testimi i ngritjes së shërbimeve në rast fatkeqësie

Drejtorati i TI-së vitin e kaluar ka krijuar dokumentin “Procedurat për Rimëkëmbjen e TI-së në Rast Fatkeqësie”, ky dokument përshkruan procedurat që duhet të ndjekin Administratorët e TI-së së AKK-së për rimëkëmbjen e sistemeve teknologjike në rast fatkeqësive. Ky dokument parasheh që këto procedurat të ndjekën dhe testohen çdo 6 muaj, respektivisht në qershor dhe nëntor të çdo viti. Testimi i rregullt 6 muajor është bërë në qershor dhe nëntor të këtij viti, ku janë ngitë shërbimet në qendrën sekondare të të dhënave duke simuluar gjendjen e reale të një “Disaster Recovery”. Testimi ka dalë të jetë i suksesshëm dhe virtual makinat janë kthyer përsëri në gjendjen normale në qendrën e parë të të dhënave.

Monitorimi

Stafi i TI-së bënë monitorim të vazhdueshëm të infrastrukturës së TI-së në qendrën primare dhe sekondare (DRC). E gjithë infrastruktura e TI-së përmes sistemeve siç janë SolarWinds, vRealize Operations Manager dhe pajisje me sistem të vetin monitorues, monitorohen 24/7 dhe notifikojnë me email stafin e TI-së për ndonjë problem që mund të paraqitet në pajisje\sisitem.

Përveç sistemeve të monitorimit të lartcekura është implementuar edhe monitorimi i webfaqeve nga jashtë (interneti) duke parë se AKK tani më ka disa web faqe publike e të cilat duhet të jenë të qasshme pa ndërprerje pasi që shpeshherë faqet janë të qasshme nga rrjeti i brendshëm mirëpo jo nga interneti. Pas nxjerrjes së raporteve nga sistemet monitoruese del që për vitin 2020 e gjithë infrastruktura e TI-së ka qenë “UPTIME” 99.43%, ndërsa të gjitha aplikacionet e AKK-së kanë qenë të qasshme nga rrjeti i brendshëm 99.91%, ndërsa nga rrjeti i jashtëm (interneti) 99.7 %.

Shfrytëzimi i resurseve harduerike (CPU, RAM dhe DISK) gjatë vitit 2020 në krahasim me vitin paraprak është rritë si në vijim: CPU 18.08%, RAM 13.31% dhe DISK 9.09%.

Azhurnimi i sistemeve operative në AKK dhe ZKK

Pasi që sistemi operativ Windows 7 nuk do të ketë më përkrahje nga Microsoft është analizuar mundësia e automatizimit të ngritjes së sistemeve operative tek kompjuterët e Domenit nga distanca. Janë krijuar kornizat e punës të cilat e automatizojnë të gjithë procedurën e instalimit dhe konfigurimit të sistemit të ri mbi të vjetrin duke mos ndikuar në të dhënat dhe aplikacionet. Në AKK dhe ZKK në total janë azhurnuar 286 kompjuter.

Statistika, raporte dhe analiza në databaza kadastrale

NNjë prej aktiviteteve me konsumim më të lartë të resurseve në DTI janë edhe zhvillimet e TSQL skriptave në nivel të databazave (MS SQL Server) për përgatitjen e raporteve dhe statistikave me të dhëna kadastrale, sipas nevojave dhe kërkesave.

Përveç raporteve dhe statistikave, në nivel të databazave bëhen edhe hulumtime të të dhënave, lëndëve dhe proceseve kadastrale. Aktivitet i përvitshëm është edhe kontrolli i kualitetit të të dhënave si dhe prezantimit i këtyre të gjeturave, në funksion të ngritjes së cilësisë së të dhënave dhe shërbimeve kadastrale.

10.2 PËRKRAHJA E PËRDORUESVE TË SISTEMEVE DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (SI/TI)


Gjatë këtij viti është vazhduar me përkrahjen e përdorueseve të sistemeve dhe teknologjisë së informacionit nga AKK, nga ZKK dhe përdorues të tjerë në mënyrë sistematike dhe sipas kërkesave. Mënyrat e përkrahjeve kanë qenë të ndryshme: drejtpërdrejtë në vendin e punës (AKK ose në ZKK), në largësi përmes qasjeve ‘remote’ ose përmes telefonit dhe emailit. Gjatë gjithë vitit janë përkrahë në mënyrë të vazhdueshme të gjithë përdoruesit aktiv në këto çështje:

- Formatizimi i kompjuterëve,
- instalimi i Windwos-it,
- instalimi i drajverave dhe programeve për punë për pjesën tekstuale dhe grafike, instalimi i shfletuesve të ndryshëm të internetit,
- regjistrimi dhe reregjistrimi i kompjuterëve në domen, krijimi dhe deaktivizimi i përdorueseve në Active Directory,
- resetimi dhe zhblokimi i fjalëkalimeve të përdorueseve të domenit dhe email-it zyrtar,
- arkivimi i email-ve, instalimi i printerëve dhe skanerëve,
- lejimi dhe ndalimi i qasjeve në follderë të caktuar, printerë, skanerë etj, mapimi i follderëve, printerëve dhe skanerëve dhe bërja share edhe për shfrytëzuesit e PC-ve tjera,
- përkrahje edhe përmes telefonit se si të kyçen në PC ose në sistemet tjera, kopjimi i shënimeve në CD,
- shkarkimi i shënimeve, ndërrimi dhe konfigurimi i IP adresave,
- instalimi dhe konfigurimi i VPN-it dhe krijimi i qasjes remote nga shtëpia etj.

Zyrtarët e ZKK-ve, janë përkrahur po ashtu edhe përmes Sistemit të informacionit SIKTK-SOA: përkrahje në regjistrim, përpunim , dhe në modifikim të lëndëve. Janë përkrahur edhe gjatë fazës kur njësia kadastrale ose pronari ka mbetur në proces (i bllokuar) gjatë aprovimit/refuzimit të lëndëve, apo edhe në raste të ndërrimit të lëndëve pas përzgjedhjes së parë . Gjatë gjithë vitit 2020 përdoruesit e AKK-së janë përkrahur në mbi 400 raste nga stafi i DTI-së, ndërsa përdoruesit e ZKK-ve janë përkrahur në rreth 900 raste.

10.3 IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË SË TI-SË

Plani i implementimit të Strategjisë së TI 2017-2021, ofron udhërrëfyesin për implementim të aktiviteteve të grupuara në paketa punuese (work packages). Gjatë këtij viti është punuar në paketat punuese: WPCD01 (Implementimet e reja në SIKTK-T), WPCD06 (Implementimi i ESB dhe integrimi i sistemeve) dhe WPCD09 (Ndërlidhja e të dhënave kadastrale dhe atyre të adresave me datasetet tjera qeveritare).



Infrastruktura e TI në AKK

11. MARRËDHËNIE ME PUBLIK DHE GJITHËPËRFSHIRJA

GAZETA PERIODIKE “KADASTRA”

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes së palëve të interesit rreth mandatit, aktiviteteve, projekteve dhe produkteve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës si dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve, AKK ka vazhduar shtypin dhe publikimin e gazetës periodike të saj “KADASTRA”, që ka për qëllim informimin e palëve të ndryshme të interesit mbi aktivitetet, produktet, shërbimet dhe projektet e saja. Gjatë vitit 2020 janë shtypur 8 edicione të gazetës dhe secili numër iu është shpërndarë më shumë se 100 institucioneve publike në Republikën e Kosovës.

UEB FAQJA ZYRTARE

Faqja zyrtare e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (www.kca-ks.org) është një nga kanalet kryesore të komunikimit në mes të AKK-së dhe qytetarëve, me rreth 33,000 vizitorë unikë dhe 216,052 shikime për gjatë vitit 2020. Në faqen e internetit janë publikuar të gjitha aktivitetet, projektet, produktet dhe shërbimet e orfruara nga AKK, legjislacioni që mbulon fushën e kadrës dhe administrimin e tokës, aktivitetet e sektorit publik. Gjatë vitit 2020 në faqen e AKK-së janë publikuar rreth 180 lajme nga aktivitetet e ndryshme.

FACEBOOK

Agjencia Kadastrale e Kosovës po ashtu ka edhe faqen e saj zyrtare në rrjetin social Facebook ku shpalos informacione të rëndësishme rreth aktiviteteve të saja. Sikurse edhe në faqen zyrtare, edhe në Facebook gjatë vitit janë postuar rreth 180 lajme. Përndryshe faqja është pëlqyer dhe përcjelllet nga 5,055 shfrytëzues të rrjetit social apo rreth 1,000 më shumë sesa në vitin 2019. Po ashtu, AKK pos si konsumuese e trajnimeve për kuadrot e saja, është edhe ofruese e trajnimeve për palë të ndryshme të interesit. Në vijim është edhe një përmbledhje e trajnimeve që ka ofruar AKK.



12. MANIFESTIM PËR 20 VJETORIN E THEMELIT TË AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

Agjencia Kadastrale e Kosovës shënoi 20 vjetorin e themelimit të saj. Në mesin e aktiviteteve të parapara për këtë përvjetor jubilar, shumica u të cilave u pamundësuan edhe nga situata e krijuar nga pandemia, ishte edhe ceremonia e shpërndarjes së mirënjohjeve për të gjithë ata që kontribuan për themelimin dhe zhvillimin e kësaj Agjencie ndër vite. Për këtë arsye, duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së pandemisë dhe rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Insitutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, me datë 10 dhjetor 2020, në ambientet e hotelit “Emerald”, në prezencën e shumicës së laureatëve të këtyre mirënjohjeve, nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti dhe zv. Ministrija e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit z-nja Burbuqe Bakia Deva ishin shpërndarë mironjohjet për kontribut.

Përmes fjalëve të rastit, edhe z. Ahmeti edhe z-nja Bakia Deva falënderuan secilin prej laureatëve për kontribunit e tyre, duke vlerësuar qoftë angazhimin profesional dhënë brenda Agjencisë qoftë për konitbutin e dhënë prej nga jashtë Agjencisë duke qenë të përfshirë në fushën e gjeodezisë, kadastrës, pronës e gjeoinformacionit.



13. VIZIONI PËR VITIN 2021

REFORMAT DHE PROJEKTET

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e saja, AKK ka indentifikuar sfidat me të cilatëshhtë ballafaquar gjatë vitit 2019, dhe për të cilat kishte hartuar edhe reforma të cilat do të ndihmonin në tejkalimin e këtyre sfidave, e të cilat mbështetet në katër aspekte kryesore, si aspekti ligjor, aspekti organizativ, aspekti i teknologjisë së informacionit dhe aspekti i gjithëpërfshirjes shoqërore. Fatkeqësisht, shkaku i pandemisë gjatë vitit 2020, edhe pse ishte paraparë, nuk kishte shumë avancime në këto aspekte dhe të njëjtat mbeten të vlefshme për vitin 2021.

REFORMAT NË KADASTËR

Në bazë të ligjeve të Republikë së Kosovës, AKK është institucion përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrit të pronave të paluajtshme, për kadastër, gjeodezi, hartografi, sistemin e adresa si dhe për Infrastrukturën Kombëtare të informacioneve Hapësinore (NSDI). AKK mund të cilësohet një ndër institucionet më të rëndësishme shtetërore.

Zhvillimet në fushën e administrimit të tokës dhe kërkesat gjithnjë në rritje nga palët e ndryshme për të dhëna të sakta, të sigurta, të hapura, qasje të shpejt në të dhëna, janë duke imponuar ndryshime dhe avancime ligjore, avancime në teknologjinë e informacionit edhe në vendin tonë. Sidoqoftë, edhe pse sfiduese, kjo nuk është e paarritshme. AKK e ka të qartë vizionin dhe i ka të qarta reformat që duhet ndërmarrë me qëllim të avancimit të administrimit të tokës në një vijë me shtetet e zhvilluara dhe në pajtueshmëri me kërkesat e komunitetit të shteteve anëtare të BE-së, me një ekzekutiv të ri për nga mosha e të avancuar për nga profesionalizmi, me një përkrahje politike, mund të ia del që kadastrën e Kosovës ta rreshtojë përkrah institucioneve homologe të shteteve të zhvilluara.

Reforma e shpesh përmendur e kadastrës, duhet të fokusohet në katër aspekte si vijon:

- ligjore,
- organizative,
- teknologjia e informacionit,
- gjithëpërfshirja shoqërore.

Në përgjithësi, këto aspekte do të ndikojnë në fuqizimin e administrimit të tokës, do të ndikojnë në shmangien e duplikimit të projekteve e që do të rezultojë me kursim të buxhetit, kohës, resurseve njerëzore e ngjashëm, do të ndikojnë në përmirësimin e efikasitetit, ballafaqim produktiv me kërkesat e ndryshme e gjithnjë në rritje e gjithnjë e më specifike, do të rrisin transparencë dhe llogaridhënie, do të koordinojnë dhe konsolidojnë prodhimin e të dhënave dhe qasjen në to, do të thjeshtojnë procedurat dhe do të shkurtojnë procedurat administrative për regjistrim të pronës, etj.

ASPEKTI LIGJOR

Ligji për kadastrë

AKK është në proces të avancimit të kornizës së saj ligjore, ndërsa reforma kryesore dhe qenësore, pa të cilën nuk mund të ketë as zhvillim të mirëfilltë, është Ligji i ri për kadastrë. Ky ligj parasheh vertiklizimin e administrimit të sistemit kadastral, respektivisht sistemimin e zyrave kadastrale komunale nën ombrellën e Agjencisë Kadastrale Kosovës.

Për të sqaruar, vertiklizimi nuk parasheh centralizimin e shërbimeve, për më shumë, ato do të jenë edhe më afër qytetarëve falë aplikacioneve të reja që AKK ka planifikuar ti zhvillojë. Për më shumë, vertiklizimi i administrimit të kadastrës do të ndikonte në ngritjen e kualitetit dhe sigurisë të të drejtave pronësore dhe do të ndikonte në ngritjen e profesionalizimit të ofruesve të shërbimeve.

Aktualisht, pasi që pozita e drejtorit në ZKK bëhet përmes emërimit politik, kemi raste që ZKK udhëhiqen nga poetë e filozofë, e kjo nuk do të duhej të ndodhte. Ligji i ri do të obligonte që me këto dikastere të udhëheqin profesionistët. Po ashtu vertiklizimi do të ndikonte në eliminimin e mundësive për korrupsion. Aktualisht, ekziston një përshtypje që nëpër ZKK ka pagesa joformale për shërbime, të raportuara nga qytetarët. Ligji i ri, respektivisht vertiklizimi i administrimit të kadastrës e ndalon një gjë të tillë, pasi që me vertiklizim do të avancoje llogaridhënia.

Dhe për fund, vertiklizimi do të lehtësonte krijimin e politikave të avancuara në administrimin e tokës dhe do të lehtësonte vendimmarrjen. Futja e Zyrave Kadastrale Komunale nën ombrellën e AKK-së do të unifikonte mënyrën e ofrimit të shërbimeve nëpër ZKK. Sot, mënyra e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve nëpër ZKK dallon. Madje, edhe çmimet për të regjistruar pronën dallojnë. Për shembull, Komuna e Prishtinës implementon një lloj pagese për blerje të pronës,

që nuk është rast në Komunitet tjerë. Një organizim i tillë i kadastrës aplikohet në të gjitha vendet e regjionit si dhe në shumicën e vendeve të BE-së.

Ligji për IKIH (Infrastruktura Kombëtare e të Dhënave Hapësinore)

AKK bazuar në ligjin për kadastrë në fuqi është koordinatore për koordinimin e aktiviteteve për IKIH. Për më shumë, mbështetur në këto kompetenca ligjore, AKK ka krijuar strategjinë për IKIH, gjatë draftimit të së cilës janë identifikuar institucionet që prodhojnë, administrojnë dhe mirëmbajnë të dhëna gjeohapësinore. Një numër i vogël i këtyre dhënave janë në Gjeoportalin Shtetërorë, andaj të dhënat tjera që nuk janë të publikuara në gjeoportalin shtetëror nuk janë të qasshme për institucionet e publikun.

Jashtë vullnetit të AKK-së për ti hapur të dhënat, kompetencat që burojnë nga ligji në fuqi për kadastrë nuk janë të mjaftueshme për të krijuar një infrastrukturë gjeohapësinore sikurse e kërkon Direktiva Evropiane INSPIRE, për këtë arsye AKK ka draftuar edhe Ligjin për IKIH. I njëjti ka kaluar në lexim të dytë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky Ligj rregullon mënyrën e grumbullimit dhe shpërndarjes së të dhënave gjeohapësinore të prodhuara nga institucione publike, konform Direktivës Evropiane INSPIRE 2007/2,

direktivë kjo obligative për shtetet anëtare të BE-së dhe ato që aspirojnë anëtarësimin në BE, përfshi edhe Republikën e Kosovës. Kalimi i këtij ligji, shpërndarjen e të dhënave të sakta, të harmonizuara e në kohë reale, do ta bëjë obligative. Përfitimi nga një proces i tillë do ishte i madh, pasi qasja në grupe të shumta të të dhënave, prodhuar nga institucione të ndryshme, do të bëhej përmes një adrese të vetme, atë të gjeoportalit shtetëror.

ASPEKTI ORGANIZATIV

AKK brenda strukturës së saj organizative ka Zyrën Ekzekutive, pesë Drejtorë dhe një numër ekspertësh që varijon varësisht nga përkrahja e donatorëve, po ashtu edhe nga projekti i Bankës Botërore REGIP në kuadër të Njesisë për Implementimin e Projekteve. Në total, AKK ka 54 zyrtarë, prej të cilëve vetëm 13 janë nga fusha e kadastrës dhe gjeodezisë. Ndërsa, implementimi i një vargu të madh projektësh nga një numër i vogël ekspertësh paraqet sfida të madhe, e sidomos kur të merret parasysh fakti që ekspertët e angazhuar nga donatorë dhe nga Banka Botërore janë me periudhë të caktuar kohore. Prandaj, reformat organizative janë të varura nga reforma e sipër përmendur ligjore.

kryesisht pilotime, dhe rezultatet nga këto pilot projekte kanë qenë të kënaqshme. Por, për të pasur gjithëpërfshirje në shfrytëzim të të drejtave pronësore, nuk mjafton vetëm kornizë ligjore në fuqi, por duhet edhe investime në aktivitete përcjellëse, shpërndarje të informacioneve, në prezantim të procedurave dhe masave ekzistuese lehtësuese për regjistrim të pronës në emër të dy bashkëshortëve, duhet targetuar edhe ndryshimin e qëndrimit në përgjithësi rezistues në opinion për trajtimin e gruas dhe të drejtës së saj në pronë.

Komunitetet pakicë dhe prona AKK trajton me kujdes të shtuar edhe specifikat që kanë të bëjnë me qasjen në të drejta pronësore për komunitetet pakicë, me theks të veçantë komunitetin serb. AKK respekton përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës dhe kujdeset që secilin qytetar ta shërbejë në gjuhën e kuptueshme për të. Shumicën e aplikacioneve që Agjencia ka krijuar, kanë edhe gjuhën serbe (dhe jo vetëm serbe) si pjesë përbërëse të tyre, përfshi Gjeoportali, Ueb Faqja, Apliakcioni për Sistemin e Adresave, Harta Kadastrale etj.

Po ashtu, secili produkt i Agjencisë, qoftë Certifikatë pronësie, Kopje plani e tjera, ofrohet edhe në gjuhën serbe. Mirëpo, sfiduese është që në tre Komunat veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan, nuk funksionojnë ZKK. Rrjedhimisht, qytetarët e atyre Komunave nuk po mund të pajisen me dokumente zyrtare pronësore të Republikës së Kosovës. Për të shmangur një gjë të tillë, AKK ka marrë përsipër pajisjen e këtyre qytetarëve me dokumente pronësore të Republikës së Kosovës. Por kjo ka qenë një zgjidhje e përkohshme, pasi që Ekzekutivi i AKK-së është duke bërë përpjekje për funksionalizimin e zyrave kadastrale komunale në këto Komuna. Për këtë, ka identifikuar disa palë të interesit si UN HABITAT që janë duke ndihmuar.

AKK kërkon përkrahje politike për funksionalizimin e këtyre zyrave, që pos praktike, do të ishte edhe një fitore politike karshi strukturave paralele atje. Realizimi i këtyre reformave në këto 4 shtylla kryesore dhe jo vetëm, do të sillte benefite direkte për të gjitha palët e interesit veçanërisht për qytetarët pasi që do të ulej në minimum burokracia, do të respektohej rregulli i aplikimit “i pari që aplikon, i pari shërbehet”, do tu ofroreshin shërbime online të cilat do të kursenin kohën për qytetarët, duke u monitoruar dhe shtuar konkurrenca e tregut tek gjeodetët dhe kompanitë gjeodete të licensuara qytetarëve do tu ofrohen më shumë mundësi zgjedhjesh, e që si çdo ekonomi e lirë e tregut por e monitoruar

do të nënkuptonte ofrim të shërbimeve më të mira, më të sakta dhe më të shpejta për qytetarët. Gjithashtu përmes këtyre reformave do të luftohej informaliteti që sot ekziston në tregun e punës së gjeodetëve pastaj do të eliminohej mundësia e keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe korrupsioni pasi që zyrtarët në ZKK nuk do të kenë nevojë në asnjë hap të procedurës të kenë kontakt me palët e interesit që janë kryesisht qytetarët, por do të jenë më të fokusuar kontrollimin, aprovimin dhe regjistrimi e të dhënave kadastrale.

Në rast të aprovimit të ligjit të ri për kadastër, Agjencisë Kadastrale të Kosovës i hapet rruga për riorganizimin e drejtorive të brendshme, respektivisht për shtimin e numrit të ekspertëve të fushës dhe shmangien e procedurave burokratike. Një aspekt tjetër që ka të bëjë me reformën organizative ka të bëjë edhe me fushën e administrimit të të dhënave gjeohapësinore. AKK e ka më se të nevojshme ngritjen e njësisë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore, pasi që AKK është administratore dhe koordinatore për IKIH në Republikën e Kosovës, dhe si e tillë e ka patjetër që të krijojë njësinë e sipër përmendur.

ASPEKTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Zhvillimet në teknologjinë e informacionit në administrimin e tokës, kërkesa në rritje për të dhëna të sakta dhe të shpejta, hapja e të dhënave, krijimi i ueb shërbimeve dhe e-shërbimeve, janë duke e shpërfaqur nevojën për reforma në teknologjinë e informacionit në AKK, e jo vetëm. AKK ka krijuar një varg aplikacionesh për administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave hapësinore si Gjeoportali Shtetëror, Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK pjesën tekstuale dhe grafike), Aplikacionin për Informacione të Sistemit të Adresave (ARIS), Aplikacionin për Administrimin dhe Indeksimin e Dokumenteve të Skanuara Kadastrale, dhe për shumicën e produkteve të saja ka krijuar ueb shërbime.

Sot AKK ofron rreth 70 lloje të të dhëna gjeohapësinore për shikim online, pa pagesë. Sidoqoftë, sfida paraqet mungesa e nënshkrimit elektronikë dhe vulës elektronike. Implementimi i tyre nuk është nën kompetenca të AKK-së. Me krijimin e këtyre dy produkteve, nënshkrimit dhe vulës elektronike, AKK do të jetë e gatshme të krijojë e-shërbime, po ashtu edhe të krijojë një “ONE STOP SHOP”, pra pajisjen me të gjitha produktet pronësore dhe kadastrale në ueb.

ASPEKTI I GJITHËPËRFSHIRJES SHOQËRORE

Gruaja dhe prona AKK parasheh përfshirjen sa më të madhe dhe sa më aktive të qytetarëve gjatë implementimit të projekteve të saja, me qëllim që të njëjtit të jenë pjesëmarrës në tregun e pronave dhe përfitues nga zhvillimi i tij. Kjo për shkak se të drejtat pronësore luajnë një rol të madh edhe në avancimin e mirëqenies së qytetarëve si përmes shitblerjes së pronave po ashtu edhe përmes hipotekimit për nevoja të kredi marrjes. Po ashtu, AKK rëndësi të veçantë u kushton përfshirjes së grupeve potencialisht të marginalizuara në të drejta pronësore, me theks të veçantë gratë, komunitetet pakicë dhe personat me nevoja të veçanta. AKK ka implementuar projekte të ndryshme për avancimin e të drejtës së gruas në pronë,

14. KALENDARI KRONOLOGJIK



14 Janar, takimi i parë i menaxhmentit për vitin 2020



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



15 Janar, vizitë në Komunën e Pejës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



16 Janar, takim me FSK



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



21 Janar, nënshkruhet vazhdimi i bashkëpunimit me JICA



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



30 Janar, punëtori për azhurnimin e doracakëve profesional



3 Shkurt, takim me Policinë e Kosovës



4 Shkurt, AKK-JICA, vazhdon bashkëpunimi



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



4 Shkurt, UN HABITAT, takim pune në AKK



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



5 Shkurt, "SPATIAL II", takim regional në Shkup



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



16 Janar, përfshirja e qytetarëve në projekte



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



6 Shkurt, takim me ndërmjetësuesit e licencuar



10 Shkurt, Trajnim për gjeodetët kandidatë për licencim



11 Shkurt, trajnim para lincencimit, grupi i dytë



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



11 Shkurt, takim me Kryeshefit e Postës së Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



13 Shkurt, takim për funksionalizimin e ZKK Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



14 Shkurt, nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim me homologët maqedonas



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



22 Shkurt, gjeodetët i nënshtrohen certifikimit



25 Shkurt, Master Plani i Ujitjes në Kosovës, punëtori



26 Shkurt, takim pune me FSK



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



27 Shkurt, pjesëmarrje në tryezë diskutimi mbi regjistrimin e pronës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



2 Mars, AKK dhe Posta e Kosovës nënshkruajnë Memorandum Bashkëpunimi




Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



3 Mars, takim me JICA



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



3 Mars, prezantim i draftit të planit të biznesit




4 Mars, implementimi i marrëveshjes KOPOS-MAKPOS



5 Mars, homazhe në kompleksin memorial në Prekaz



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



6 Mars, shpërndahen licencat për gjeodetë



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



8 Mars, takim pune mes ekzekutivit dhe grave të punësuar në Agjenci




Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency




12 mars, aktet e ndërmjetësismit, takim pune në AKK



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



18 Mars, dezinfektimi i AKK-së shkaku i pandemisë



23 Mars, takimi i parë virtual i menaxhmentit



27 mars, takimi i parë i menaxhmentit në kushte pandemie



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



21 prill, nënshkruhet korniza për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



4 Maj, takim virtual mbi legalizimin



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



11 Qershor, takimi i nën-komitetit për drejtësi, liri dhe siguri



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



16 Qershor, Legalizimi, takim në AKK




2 Korrik, takim me shoqatën e bankave



9 Korrik, takim me Shoqatën e Bankave



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



9 Korrik, takim me USAID



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



14 Korrik, fillojnë takimet me bankat komerciale



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



17 Korrik, takim me FSK



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



21 Korrik, dezinfektimi i dytë në AKK



30 Korrik, takim me ZKK Suharekë



11 Gusht, takim me Këshilltarët e Ministrisë së Ekonomisë e Ambientit



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



12 Gusht, takim virtual i grupit punues për standardizimin të shfrytëzimit të adresave



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



15 Gusht, mbahet testimi për licencim



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



26 Gusht, takim për ligjin e ri për kadastrë



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



27 Gusht, takim me Odën e Përmbauesve



26 Gusht, Takim me Drejtorin për Tatim në Pronë



2 Shtator, takim teknik me përfaqësues të Odës së Përmbaruesve



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



2 Shtator, përfaqësues të Ambasadës Amerikane dhe të FSK vizitojnë AKK



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



3 Shtator, vizitë pune në Komunën e Fushë Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



9 Shtator, vizitë pune në Komunën e Artanës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



10 Shtator, takim me drejtorët e ri të emëruar në ZKK



10 Shtator, takim me Agjencinë Anti Korrupsionit



11 Shtator, vizitë pune në Komunën e Klinës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



11 Shtator, shpërndahen licencat për gjeodetë



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



15 Shtator, memorandum bashkëpunimi me AKI



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



25 Shtator, takim me Kryetarin e Rahovecit



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



29 Shtator, fillon trajnimin e përmbaruesve privat



29 Shtator, takim me Forumi për Shkëmbim të të dhënave



1 Tetor, takim me AKKVP



1 tetor, mbahet testimi i rradhës për licencim



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



5 Tetor, takime të ndara mes drejtorëve dhe personelit në AKK



7 tetor, nënshkruhet Memorandum Bashkëpunimi në mes të AKK dhe ONK



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



9 Tetor, mbledhet grupi punues për ligjin e ri për kadastrë



14 Tetor, grupi teknik i AKKVP viziton AKK



15 Tetor, Agjencisë Anti Korrupsion i sigurohet qasje në regjistrat pronësore



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



19 Tetor, shpërndahen licencat për gjeodetë




Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



23 Tetor, nënshkruhen dy marrëveshje me homologët nga Republika e Shqipërisë



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



30 Tetor, sfidat e legalizimit, takime pune në AKK



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



2 Nëntor, Regjistrimi i popullsisë, bashkëpunim AKK-ASK



4 Nëntor, takim me Kryetarin e Prizrenit



12 Nëntor, Ministri Kuçi vition AKK



16 Nëntor, takim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



17 Nëntor, nënshkruhet marrëveshje me Këshillin Prokurorial të Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



17 Nëntor, Marrëveshja e Mirëkuptimit me Policinë së Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



19 Nëntor, takim me Drejtorin e Administratës Tatimore



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



3 Dhjetor, Marrëveshja për Bashkëpunim me NjIF



8 Dhjetor, Besnik Tahiri viziton AKK me rastin e 20 vjetorit të themelimit



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



9 Dhjetor, Marrëveshja për Bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



10 Dhjetor, shpërndahen mirënjohje për kontribut




Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



11 Dhjetor, Kreu i Zyrës së BE-së në Kosovë z. Tomáš Szunyog, viziton AKK-në



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



11 Dhjetor, Ambasadori Jan Braathu viziton AKK-në




14 Dhjetor, mirënjohje për SIDA-n



14 Dhjetor, Marrëveshja për Bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës




Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



16 Dhjetor, Trajnim/Webinar për rolin e gjeodetit në komasacion



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



16 Dhjetor, Kryeshefi dhe Zv. Ministrija e MEA, takim me Kryetarin e Komunës së Gjakovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency




24 Dhjetor, trajnim i avancuar për FSK në fushën e hartografisë



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



24 Dhjetor, takim me ish-bashkëpunëtorë me rastin e 20 vjetorit



28 Dhjetor, trajnime për operim në RDPP

